




IN MEMORIAM



**PËR NJË SHQIPËRI
SI EUROPA, ME
DEMOKRACI
PERËNDIMORE**
LULZIM BASHA

Faqe 2

DENONCIMI



**SKANDALI ME "RRUGËN
E ARBRIT"/ "GJOKA
KONSTRUKSION"
DORËZOI INFORMA-
CIONE TË RREME**

Faqe 4

FESTIVALI



**25 VJET "ODA
DIBRANE"**

• NË KËTË FESTIVAL SI PËR ÇDO
VIT MORI PJESE EDHE GRUPI
FOLKLORIK I QENDRËS KULTU-
RORE BULQIZË

Faqe 5

Presidenti Ilir Meta mori pjesë në Simpoziumin Shkencor: "110 vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar"

PRESIDENTI META: DIBRA, EPIQENDËR E SHQIPTARIZMIT

**ZGJEDHJET
NË KOSOVË,
LEKSION
DEMOKRACIE**

NGA EDMOND ISAKU

Anëtar i Këshillit Kombëtar PD-së



Zgjedhjet e fundit në Kosovë me qetësinë, kulturën demokratike, zbatimin e Kodit Elektorral, debatin elektorral të përmbajtur, pa eksese dhe pa konfrontime që shpesh herë i kemi përjetuar në Shqipëri, përbëjnë një leksion demokracie edhe për Shqipërinë, e cila më shumë se kurrë sot po kërkon të ngrihet në standardin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Dalja dhe pranimi i rezultateve shpejt dhe pa bujë e rrëmujë, përbën një shembull që ka vend për të mësuar edhe Shqipëria. Kësaj here në Kosovë u votua për ndryshim, dhe ky ishte emërtuesi i përbashkët; qe një votë shumice kritike që u dha për të ndryshuar qeverisjen.

Këto zgjedhje kanë diçka më shumë se ç'prodhon një rrotacion politik, ku opozita fiton në garë më partitë në pushtet. Për Kosovën kjo është një shpresë e re që lind. Alternativat politike konkurruese respektuan Kodin Zgjedhor.

Vijon në faqen 3



• 13 Shtator 2019 - Presidenti Meta vlerëson Shoqatën "Bashkësia Dibrane" dhe personalitete të shquara të kësaj treve atdhetare: Malet e Dibrës ngelen përherë bastioni dhe barrikatat e para të betejave për liri e pavarësi

Faqe 6-7

Promovimi Më 26 Tetor, ora 11.00 promovimi i librit të pestë të Ramazan Kicës në Muzeun Historik Kombëtar

Romani "Lulja" me episode nga Bulqiza, si skaner i diktaturës

• Nëpërmjet një procesi të gjatë e të ndërlikuar krijues, autori Kica dëshmon aftësinë për të treguar, për veten dhe për botën, për jetën dhe bëmat makabare të atij sistemi që degradoi deri në kalbëzim, duke përdhosur shoqërinë dhe familjen.

Faqe 10



REAGIMI

Faqe 2

Mund të goditet një shtatore, por jo historia e lavdishme e Mbretit ZOG I



DHURATA ÇUPI

REFERATI

Faqe 8

Për Kongresin e Manastirit dhe të Dibrës të para 100 vjetëve



PROF. BAJRAM XHAFI

LIBRI

Faqe 11

Origjina e gollobordasve të Dibrës (Kalabardhët)
NGA AGIM R. KASA




LETRAT

Faqe 12

Arti i fjalës

-Poezi nga Barie Çupi

Kur fuqishëm dridhet zemra,
Afrohu të lutem njëherë ngadalë;
Lexo syrin çfarë sheh brenda,
Det me fjalë, i njejt mall...



Për një Shqipëri si Europa, me demokraci perëndimore



LULZIM BASHA*

72 vite më parë, më 10 tetor 1947, në një akt të pashembullt të eliminimit të elitës së kombit shqiptar, për interesa pushteti diktatura komuniste pushkatoi 16 të pafajshëm, 5 prej të cilëve deputetë, në një gjyq të montuar që ka hyrë në histori si gjyqi i parë i dënimit të deputetëve. Me vendim të vetë diktatorit dhe me frymëzim bolshevik, në Shqipëri po grisej edhe formalisht veli i opozitës politike dhe përfaqësues nga të gjitha krahinat e vendit, intelektualë me formim perëndimor, klerikë të njohur e të angazhuar aktivisht në luftë kundër pushtuesve të huaj, si dhe tribunë të lëvizjes për rreshtimin e Shqipërisë në krah të demokracive perëndimore, u dënuan me pushkatim dhe vendimi u ekzekutua me urgjencë brenda dy javësh, nëpërmjet një vrasjeje mizore masive në Malin me Gropa.

Pinjollë të familjeve të njohura e me tradita patriotike, u nxorën para gjyqeve politike, në përpjekje për të shkatërruar njëherë e mirë çfarëdolloj opozite që mund të prodhonte shoqëria shqiptare ndaj sistemit diktatorial komunist që po impononte klika e ardhur

• 72 vite më parë, më 10 tetor 1947, në një akt të pashembullt të eliminimit të elitës së kombit shqiptar, për interesa pushteti diktatura komuniste pushkatoi 16 të pafajshëm, 5 prej të cilëve deputetë, në një gjyq të montuar që ka hyrë në histori si gjyqi i parë i dënimit të deputetëve



në pushtet me dhunën e pushkës. Pas gjyqit të parë të deputetëve, ku xhelati ishte përkujdesur të përzgjidhte personalitete nga Shkodra, Tirana, Gjirokastra, Dibra, Lushnja, apo edhe Prishtina, me urdhër të vetë diktatorit, pati edhe dy valë të reja gjyqësore në vitin pasardhës, ku me varje, pushkatime apo me burgime të përjetshme u dënuan 15 deputetë, dhe dhjetëra bashkëpunëtorë të tyre.

Duke analizuar terrorin, udhëheqja xhahile vlerësoi se e kishte likuiduar njëherë e mirë rrezikun e krijimit të një opozite politike në vend. Kjo, sipas vetë dokumenteve të Sigurimit të Shtetit, ishte arritur përmes torturave çnjerëzore, si elektroshtoku apo lënia pa ushqim për një vdekje të ngadaltë, tortura që u përdorën mbi ajkën e kombit e sipas një manuali të vërtetë shkombëtarizues.

72 vjet më vonë, ndjehemi krenarë për deklaratat që ata deputetë, tribunë të vërtetë të mendimit shqiptar, dhanë në gjyqin e montuar. Ata u shprehën troç se nuk e donin regjimin që ishte ngritur në Shqipëri e se ata ishin organizuar e po përpiqeshin për një Shqipëri si Europa, një Shqipëri me demokraci perëndimore.

Përkundër dhunës çnjerëzore, ata i dolën zot orientimit perëndimor të shqiptarëve dhe i deklaruan botës se komunizmi nuk ishte një zgjedhje e lirë e popullit shqiptar, por, një regjim që u instalua dhe iu imponua popullit me dhunë e me gjak dhe që u mbajt me dhunë dhe me gjak.

72 vjet më vonë, në Shqipëri kemi një parlament monist, ku çdo ditë mendohet si të prodhohen ligje për të vjedhur e plaçkitur shqiptarët dhe pasuritë e tyre, për të ndaluar opozitën politike e

median kritike.

72 vjet më vonë, regjimi autokratiko-kriminal i drejtohet opozitës politike me të njëjtën terminologji siç u drejtohej xhelati grupit të deputetëve, duke e quajtur një forcë e errët e cila do të marrë pushtetin.

Por siç na mëson historia e na e ka lënë trashëgimi edhe përpjekja e grupit të deputetëve, askush s'mund ta ndalë ëndrrën e një populli, lirinë e tij, fatin e tij.

Fati i Shqipërisë është i shkruar dhe është në Europë. Ata që përpiqen ta ndalin këtë udhëtim, do turpërohen si etërit e tyre.

Fillimisht do turpërohen për firmat e tyre, dikur firma pushkatimi e sot firma për vjedhje masive dhe dhunime të pronës dhe lirive të qytetarëve, e më pas do përgjigjen individualisht për përgjegjësitë që kanë për mbajtjen peng të vendit.

Duke përkujtuar betejën e grupit të deputetëve, ne kemi detyrimin të ruajmë lirinë dhe demokracinë. Ato kërcënohen sot nga karikaturat e brezit të dytë të diktaturës komuniste, të shndërruara në një aradhë pa komb, që ka vetëm një kult, vjedhjen. Është një betejë e re dhe të gjitha forcat demokratike, trashëgimtare politike të platformës së paraqitur nga grupi i deputetëve, janë thirrur në skenën e historisë, për ta fituar atë bashkë me të gjithë shqiptarët e ndershëm dhe patriotë.

*Kryetar i PD-lider i opozitës shqiptare

REAGIMI

Mund të goditet një shtatore, por jo historia e lavdishme e Mbretit ZOG I

DHURATA ÇUPI TYLI

Jam ndier krenare kur një nga hapësirat më të rëndësishme të kryeqytetit shqiptar, iu rezervua shtatores së Mbretit Zog I. Një figurë e ndritur e historisë së vendit tonë, një themelues i devotshëm i institucioneve demokratike në vend, Mbreti Zog meritonte respektin maksimal të çdo shqiptari që vlerëson themeluesin e demokracisë.

Jam ndier krenare për veprën që ai la pas, por edhe si Matjane dhe për lidhjen e ngushtë familjare nga vendi i origjinës së Mbretit Zog I.

Në kohën kur u vendos shtatorja diskutimi ishte për pikëvështrimin e shtatores, e sigurisht atij i duhej lënë përballë gjithë vepra që la për kryeqytetin e sotëm.

Ndërsa në këto vite u la i pluhurosur, qëllimisht, para disa ditësh u krye akti i fundit barbar ndaj shtatores së tij duke u sulmuar dhe e bërë qëllimisht pis.



Dashakeqësit mund të godadin një shtatore por jo historinë që la pas Mbreti Ahmet Zogu, një histori që shërbeu për

themele të forta të shtetit shqiptar.

Përgjegjësit duhet të gjenden e të përgjigjen për këtë akt të turpshëm. Ftoj institucionet të kryejnë detyrën për ti kthyer origjinalitetin shtatores.

NJË AKT VANDAL

TIRANË- Një akt vandal ka ndodhur në Tiranë, ku është dhunuar shtatorja e ish-mbretit Zog, e cila qëndron e vendosur tek ish-stacioni i Trenit në kryeqytet. Në pjesën e bazamentit të kësaj shtatoresje është shkruar: Poshtë tradhtari. Spiun i Serbisë!

Mëngjesin e datës 2 tetor 2019 shtatorja e ish-mbretit Zog I është gjetur e mbushur me parulla të shkruara me grafitë ofendues ndaj figurës së tij.

Shtatorja e ish-mbretit Ahmet Zogu u vendos shtatë vite më parë, në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar. Qeveria Berisha asaj kohe do të niste

vlerësimin e figurave, duke vendosur disa buste në sheshet kryesore të kryeqytetit si vlerësim për kontributin e tyre në pavarësinë e vendit dhe në krijimin e shtetit shqiptar. Ndërkohë ka ardhur edhe reagimi i Partisë Demokratike, përmes ish-deputetes Dhurata Çupi, e cila kërkoi respekt maksimal për figurën e mbretit Zog I.

Shtatorja e Ahmet Zogut ka një lartësi prej 3 metrash dhe është vendosur në fund të bulevardit "Zogu I", pranë Stacionit të Trenit në Tiranë. Shtatorja prej bronzi u përrua në vitin 2012 nga qeveria e PD-së.

Ahmet Zogu ka qenë përfaqësues i Shqipërisë nga periudha 1925 deri më 1939, kur edhe u largua nga Shqipëria pas invadimit të Italisë fashiste. Mbreti Zog vdiq si i arratisur më 1961 në Paris. Eshtrat e tij u sollën në vitin 2012 dhe u varrosën në Mauzeliumin Mbretëror në Tiranë.

“Shqipëria po shkon pas. Dy kushte të reja nga Bundestagu janë që të arrestohen hajdutët e votave dhe po ashtu të përsëriten zgjedhjet e 30 qershorit...”

Basha: Në këtë gjendje nuk ka shanse të hysh në BE, Rama u puth me Mogherinin e kujtoi se ia hodhi

Negociatat nuk hapen as me propagandë, as me “plaçin fashistët”

• “Prej tre vjetësh mbizotëron një mosbesim nga vendet anëtare në raport me raportin e Komisionit Europian për Zgjerimin. Thënë më qartë, raportet e Komisionit Europian për Zgjerimin konsiderohen nga një pjesë e mirë e vendeve anëtare të zbukuruara që nuk paraqesin realitetin”

Negociatat nuk hapen as me propagandë, as me “plaçin fashistët”. Kështu u shpreh gjatë konferencës së tij për shtyp lideri i PD-së, Lulzim Basha menjëherë pasi BE vendosi të mos hapë negociatat me Shqipërinë. Sipas kryedemokratit, prej tre vjetësh mbizotëron një mosbesim nga vendet anëtare në raport me raportin e Komisionit Europian për Zgjerimin.

Duke iu referuar edhe deklaratës së zv/kryeministrit Erion Braçe, bërë vetëm pak çaste pasi BE i mbylli derën Shqipërisë, i cili akuzoi Europën si “fashiste” dhe “ekstremiste”, Basha deklaroi se, negociatat nuk hapen as me propagandë dhe as me sulme.

“Është e vërtetë që jo vetëm në mbledhjen ku mora pjesë në Berlin, por tash tre vjet mbizotëron një mosbesim nga vendet anëtare në raport me raportin e Komisionit Europian për Zgjerimin. Thënë më qartë, raportet e Komisionit Europian për Zgjerimin konsiderohen nga një pjesë e mirë e vendeve anëtare të zbukuruara që nuk paraqesin realitetin. Dhe këtë tha edhe Holanda, kur u shpreh se, nëse në rastin e Maqedonisë ishin dakord, në rastin e Shqipërisë, problemi i krimit, i korrupsionit dhe i ndarjes së pushteteve i ndalonte në mënyrë absolute të merrnin një vendim për hapjen e negociatave, në kontrast të qartë me raportin e zbukuruar për herë të tretë të Komisionit Europian. Këtë tha edhe Franca, jo vetëm në raport me krimin dhe korrupsionin, por edhe në raport të cilin Franca e ndjen dhe e sheh përditë, problemin e azilkërkuësve shqiptarë.

Këto janë të vërteta të cilat për fat të keq si shumë të vërteta të tjera që kanë të bëjnë edhe me proceset brenda vendit nuk kanë gjetur pasqyrimin e duhur në raportin e Komisionit Europian të Zgjerimit, as këtë vit, as vitin e kaluar, as para një viti. Dhe kjo e shtyu



Bundestagun gjerman të ndërmerret atë që ndërmerr gjithmonë, kur nuk i beson Komisionit, të bëjë vlerësimin e vet., duke i vendosur 9 kushte të forta qeverisë shqiptare”, -deklaroi ndër të tjera kryetari i PD-së.

QEVERIA, PËRGJEGJËSE TOTALE PËR MOS HAPJEN E NEGOCIATAVE ME BE-NË

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha dënon propagandën mashtruese të Edi Ramës, i cili deklaron se qeveria ka bërë detyrat, e duke gjetur armikun jashtë tij, për mos hapjen e negociatave me Bashkimin Europian. Basha tha se, Shqipëria po bën hapa mbrapa, kurse thekson se qeveria është përgjegjëse totale për moshapjen e negociatave.

“Shqipëria po shkon pas. Dy kushte të reja nga Bundestagu janë që të arrestohen hajdutët e votave dhe po ashtu të përsëriten zgjedhjet e 30 qershorit, që ishin diktatoriale. Kryeminis-

tri shqiptar vuri interesin e vet mbi interesat e shqiptarëve. Ka një përpjekje për ta paraqitur situatën sikur ka përplasje mes Francës e Gjermanisë dhe jo gjendjen e Shqipërisë.

Kjo është një tentativë qesharake. Në këtë gjendje nuk ka shanse të hysh në BE. Dil e pyet një shqiptar të thjeshtë a është gati Shqipëria e do të thotë jo. Kush nga ne nuk e di se çfarë valë emigrimi ka Shqipëria?!

Vendi ynë ka numrin e azilantëve më të madh në planet. Rama u puth me Mogherinin e kujtoi se ia hodhi. Këta thonë ne kemi bërë detyrat, plastë armiku, plastë fashisti. Në Europë nuk shkohet me propagandë”, tha Basha.

“NDARJA E POLITIKËS NGA KRIMI”, REFORMA ZGJEDHORE EMERGJENCË KOMBËTARE

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha në një konferencë për mediat menjëherë pasi BE vendosi të mos hapë negociatat me Shqipërinë, deklaroi se, një reformë zgjedhore mirëfilltë, është emergjencë kombëtare për vendin. Sipas liderit të opozitës, kjo reformë duhet ti japë fund një herë e mirë për të mos patur një sistem si ky, ku 10 njerëz janë pronarë të gjithçkaje, qeverisë, prokurorisë, gjykatave, policisë, mediave, bregdetit.

“Dua t’ju them me përgjegjësitë e reja, si kryetar i opozitës së bashkuar por edhe e shumicës që do ndryshimin, kjo nuk vjen as me një protestë e as me një reformë. E para dhe kryesorja, reformë zgjedhore që ta ndajë politikën nga krimi. Që ti japë fund një herë e mirë për të mos patur një sistem si ky, ku 10 njerëz janë pronarë të gjithçkaje, qeverisë, prokurorisë, gjykatave, policisë, mediave, bregdetit. Be kërkon arrestimin e atyre që vodhën votat.

Së dyti, sistem zgjedhor që përfaqëson dhe të pranuar nga të gjithë shqiptarët dhe ndryshime kushtetuese që bëjnë ndarjen mes pushteteve, të cilin Holanda e ngriti si problem.

Reforma zgjedhore sot është një emergjencë kombëtare. Një reformë që ia kthen qytetarëve të drejtën për të zgjedhur pushtetin që i qeveris dhe që ia merr pushtetin kur keqqeveris”, u shpreh Basha.

Problemi i Shqipërisë, jo se nuk e do Evropa, por se Piktori e bëri shtet që të mos e duan edhe shqiptarët

KIM MEHMETI

Shqipëria nuk është e rrezikuar nga ambicet e një Kryeministri që donë t’i kontrollojë të gjitha, por nga një ‘Piktor’ i dështuar dhe i frustruar që nuk mund ta kontrollojë vetveten.

Shqipëria u bë vend ku ka kush të vdes, por ku s’ka kush të të varrosë sepse aty është e turpshme të turpërohesh dhe pse thuajse çdo gjë në atë vend funksionon sipas logjikës: “Të gjithë qelbësirat tona, kundër plehut të tyre”. Po pra, Shqipërinë nuk e dëmtojnë armiqtë e jashtëm, por patriotët e brendshëm të ‘Rilindjes’, të cilët atë e shohin si lopë të cilën duhet ta ushqejë populli, e ta mjelin ata. Dhe Shqipëria nuk vuan pse ajo nuk ka njerëz të ndershëm e të vlefshëm, por pse në atë vend, më e nderuar dhe më e paguar është një dele që për çdo natë del në televizor, se sa një mësues fshati që ka në dorë ardhmërinë e vendit. Në Shqipëri kurrë nuk do ketë zgjedhje të parakohshme, sepse aty çdo gjë është e jashtëkohshme dhe nuk i takon as të sotmes, as të ardhmes e as të shkuarës, por pashpresës. Dhe problemi i Shqipërisë nuk janë vetëm elitat e gjithëllojshme tona të korruptuara, por edhe të gjithë ne që nuk shohim se mëmëdheu është shndërruar në një atelie ku ‘Piktori’ i ndërron brekushet e veta dhe ku prej moti e ka hapur ‘ekspozitën’ e pan-



djeshmërisë sonë të turpshme ndaj fatit kolektiv. Andaj, problemi më madhorë i Shqipërisë nuk është pse atë nuk e do Evropa, por pse ‘Piktori’ e bëri atë shtet që të mos e duan edhe shqiptarët. Dhe andaj Shqipëria do vazhdojë të mbetet vend kryesisht i banuar nga të pakënaqurit, por të cilët nuk e kanë kuptuar se pakënaqësia dhe revolta që nuk shndërrohet në veprim, përfundojnë ose në vajtim, ose në nënshtrim, se aty ku pakënaqësia mbetet vetëm lotëderdhje dhe vajtje e heshtur, njeriu ose pajtohet të jetojë me të keqen, ose ndërmerr atë që bëjnë të rinjtë e mëmëdheut: ikin nga hapësirat ku sundojnë vrasarët e shpresës, ku fatin e të ndershmeve e përcaktojnë hajdutët dhe kriminelët dhe ku, njerëzit pajtohen që të keqen e sotme, ta arsyetojnë e ta mbulojnë me fatkeqësinë e djeshme!

ZGJEDHJET NË KOSOVË, LEKSIONI DEMOKRACIE

(Vijon nga faqja 3)

Fituan VV e LDK, dy parti me program modern dhe bashkëkohor. Ranë partitë e kapjes së shtetit. A do të ndodhë kjo në Shqipëri? Le të shpresojmë se zgjedhjet në Kosovë do të kenë jehonën e tyre për zgjim dhe reflektim edhe këtu. Kosova po na jep leksion me dy partitë që kanë fituar zgjedhjet. Por, nëse këto dy parti do të funksionojnë brenda programeve të tyre për të hartuar një program të përbashkët, atëherë leksioni përbën vërtetë emancipim politik dhe elektoral për t’u marrë shembull. 7 tetori që lindja e një shprese të re për Kosovën demokratike. Kosova ka në gjirin e saj një konflikt të papërfunduar me Serbinë, ndërsa Shqipëria bart një konflikt të brendshëm historik midis neokomunistëve dhe demokratëve. Neokomunistët tashmë të pagëzuar me emrin “Rilindje” kanë kapur shtetin në të gjitha hallkat e tij. Të ngjashmet simetrike në realitetet politike të dy vendeve do t’i gjenim: te LDK Kosovë dhe PD Shqipëri, si parti të qendrës së djathtë, dhe LSI Shqipëri dhe VV Kosovë, si përfaqësuese të spektrit socialdemokrat të majtë. Të katër këto parti mendojmë se janë në akord të plotë me alternativën zhvilluese të BE, dhe kërkesave të kohës, për integrim evropian dhe zhvillim shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Jo vetëm duke parë ngjashmëritë dhe shembëllimin politik të dy realiteteve politike por besojmë se zgjedhjet në Kosovë janë një leksion demokracie edhe për Shqipërinë për të realizuar sa më shpejt zgjedhje të parakohshme në standarde demokratike, si e vetnija rrugë për të dalë nga kriza shumëplanëshe që ka mbëthyer politikën dhe shoqërinë shqiptare. Shtetin e kapur nga krimi dhe korrupsioni mund ta çlirojë vetëm alternative e opozitës së bashkuar.

“Gjoka konstruksion” ka marrë me koncesion ndërtimin e “Rrugës së Arbrit” për 225 milionë euro

denoncimi

Skandali me “Rrugën e Arbrit”/ “Gjoka Konstruksion” dorëzoi informacione të rreme


Kompania “Gjoka” me administrator Rrok Gjokën ka lidhur një kontratë nënkontraktore me një tjetër shoqëri, e cila ka administrator Erind Gjokën dhe që quhet “Gjoka 87”

Punimet e marra përsipër nga “Gjoka Konstruksion” nuk kanë përfunduar sipas kontratës. Kompania i ka paraqitur si të përfunduara në segmentin Zall Bastar – dalje Ura e Vashës dhe ka marrë paratë, por pas inspektimit, puna nuk është përfunduar.

Sipas Balkanweb, Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka bërë verifikimet e nevojshme për kompaninë “Gjoka Konstruksion” dhe ka zbuluar të dhënat e rreme për punët e kryera prej saj në “Rrugën e Arbrit”.

Në datën 12 shtator, ARRSH i ka kërkuar agjencisë së prokurimit publik nisjen e një procedure hetimi administrativ për kompaninë e ndërtimit “Gjoka Konstruksion”.

Konkretisht sipas raportit të ARRSH mbi verifikimin e punimeve



në nënkontratën me objekt “Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e “Rrugës së Arbrit” faza e parë, segmenti numër 3 Zall Bastar - dalje Ura e Vashës”, punimet e marra përsipër nga operatori “Gjoka Konstruksion” nuk kanë përfunduar sipas kontratës.

Ka zëra punimesh që janë paraqitur si të përfunduara por që në fakt janë të përfunduara dhe punimet në tunele vijojnë akoma. Inspektimi i kryer është realizuar pas një periudhe gati tre mujore nga data e kolaudimit, çka do të thotë se kompania është paguar nga thesari i shtetit për këto punime.

Por grupi i punës i ngritur nga ARRSH doli në përfundimin se asnjë nga tunelet e “Rrugës së Arbrit” nuk ka përfunduar dhe nuk plotëson parametrat dhe standardet e kërkuara.

Punimet e pakryera konsistojnë kryesisht në ndërtim drenazhi, torkretim me llaç, çimento, vendosje rrjete teli në skarpata zgarë hekuri, sistemi në ndriçim për njoftim evakuimi, sistemi i njoftimit të emergjencave në tunele, sistemi i detektimit të alarmit të zjarrit dhe ai i tokëzimit.

mi, sistemi i njoftimit të emergjencave në tunele, sistemi i detektimit të alarmit të zjarrit dhe ai i tokëzimit.

“Gjoka konstruksion” ka marrë me koncesion ndërtimin e “Rrugës së Arbrit” për 225 milionë euro. Kompania duhet të sigurojë paratë, të ndërtojë rrugën dhe më pas shteti e paguan, por në pamundësi për të gjetur pagesat ka falsifikuar dokumentet dhe ka marrë gati 70 miliardë lekë nga thesari i shtetit për punë të përfunduara.

Sipas ligjit, në çdo rast kur vërehen paraqitje të të dhënave të rreme është detyrim taksativ i autoritetit kontraktor të shkualifikojë operatorin që i ka paraqitur ato të dhëna dhe të nisë procedurën e përjashtimit nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Krimet e Rënda, verifikim te Rrugë e Arbrit sa për “adet”. Si mashtroi “Gjoka” me miliona euro

• Ish drejtoresha e ARRSH Sonila Qato, të cilën Rama e bëri “kurban” për hir të krushqisë Rrok Gjoka-Gaz Demi ka bërë kallëzim penal për mashtrimin në Rrugën e Arbrit. Arta Marku e Donika Prela dërgojnë për verifikim prokurorët, për t’i hedhur “hi syve” shqiptarëve

Pas përplasjes së fortë me ish drejtoreshën e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato, pronari i kompanisë “Gjoka” e cila ka marrë në koncesion Rrugën e Arbrit është vënë në qendër të goditjes së medias dhe komenteve të forta të publikut në rrjetet sociale.

Qato e akuzoi “Gjokën” se ka mashtruar me punimet e pakryera në tunelet e kësaj rruge të rëndësishme në verilindje të vendit, duke kërkuar hetim administrativ për të.

Përplasia ka qënë e pafat për ish drejtoreshën e ARRSH, e cila ndonëse nuk ka qënë “qibar” dhe e pastër në punën e saj, këtë radhë u bë “kurban” nga kryeministri Edi Rama vetëm e vetëm që të mos preken oligarkët klientë të tij, krushqia Rrok Gjoka-Gaz Demi.

Duke qënë se kjo punë ka marrë erë dhe “qelbi” i mashtrimit ka marrë zyrarisht rrugët, Donika Prela, drejtuese e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka dërguar oficerët e saj në Rrugën e Arbrit, për të kryer verifikime për llogari të hetimeve të nisura nga prokurorja Doloresa Musabelliu.

Verifikimet në terren po kryhen për të parë zbatimin e punimeve për fazën e parë, segmenti tre, të Rrugës së Arbrit në segmentin “Ura e Cerencit” Bllatë, “Ura e Vashës” dhe tunelet t4, t5, t6.

Janë tre tunele, punimet e të cilëve u deklaruan nga ana e Rrok Gjokës si të kryera me sukses, duke i paraqitur dhe në letrat e tenderit për tunelin Kardhiq-Delvinë, si një element i fuqishëm shtesë për ta fituar dhe atë tender.

Kqyrjet e sotme të grupit të hetimit nisen për llogari të hetimeve të hapura javët e kaluara, për shkak të dy kallëzimeve të ndërsjellta mes ish-drejtoreshës së ARRSH, Sonila Qato dhe një shoqërie që ka dorëzuar kallëzim për ish zyrtaren.

Mësohet se organi i akuzës nuk e ka filluar hetimin e çështjes me kryesisht, por sepse ish drejtoresha Qato denoncoi pranë Krimeve të Rënda “Gjoka Construction” me akuzën se ka falsifikuar dokumentet gjatë paraqitjes së dokumenteve në procedurën e tenderimit të rrugës Kardhiq-Delvinë.

Në kallëzimin e Qatos i thuhet prokurorisë së “Gjoka Construction” ka paraqitur dokumente sikur ka përfunduar punimet në Rrugën e Arbrit, duke kryer një mashtrim të fortë, i ngjashëm me atë të “DH-Albania” të Bashkim Ulajt, me qëllim përfitimin e miliona eurove nga ky tender.

Nga ana tjetër kompania e oligarkut klient të Ramës, dorëzoi padë përmes avokatit mbrojtës duke arsyetuar se ishte shkualifikuar nga gara për të favorizuar një firmë tjetër dhe se inspektorët në rrugën e Arbrit thjesht kishin bërë një shtetije.

Kallëzimi i kompanisë ishte për dyshimet e korrupsionit, në një kohë që më tej u përmend që gjatë garës për tunelin e Kardhiq-Delvinë ka deklaruar që ka përfunduar punimet në mënyrë pjesore dhe se punimet vazhdojnë.

Duke parë përfshirjen në hetim të Prokurorisë së Krimeve të Rënda vetëm pasi ish drejtoresha e ARRSH, Sonila Qato, bëri kallëzimin në organin e akuzës, është e sigurtë se Donika Prela ka dërguar oficerët e saj për të verifikuar në terren, thjeshtë dhe vetëm për të bërë “adetin”.

Prokuroria e Arta Markut dhe vartëses së saj Donika Prela është tërësisht nën shërbimin e Edi Ramës, duke hapur dhe mbyllur dosje për interes të tij, pasi as që ka ndërmend të hetojë dhe të dërgojë në gjykatë dosjen e mashtrimit të krushqisë Rrok Gjoka-Gaz Demi. /Pamflet

Gjoka kontratë me shoqërinë e djalit të tij, si u vlerësuan punimet

Thellohet skandali me ndërtimin e “Rrugës së Arbrit” nga kompania “Gjoka Konstruksion”.

Për të realizuar një pjesë të ndërtimeve në “përmirësimin, ndërtim-operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit” segmenti numër 3, Zall Bastar Dalje-Ura e Vashës si dhe segmenti Ura e Cerencit- Bllatë, kompania “Gjoka konstruksion” me administrator Rrok Gjokën ka lidhur një kontratë nënkontraktore me shoqërinë e djalit të tij, “Gjoka 87”, me administrator Erind Gjokën.

Kontrata me afat 12 mujor lidhet

pikërisht me punimet e konsideruara si të papërfunduara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për të cilat janë marrë paratë nga buxheti i shtetit mbi bazën e dokumenteve të rreme. Për këtë arsye ARRSH kërkoi nisjen e hetimeve për kompaninë e ndërtimit ‘Gjoka Konstruksion’.

Ajo që është e çuditshme është fakti se në këtë kontratë sipërmarrës rezulton shoqëria ‘Gjoka 87’ dhe nënshpërmarrës ‘Gjoka konstruksion’, pavarësisht se tenderin për rrugën e Arbrit e ka fituar kjo e fundit.

“Dosja.al” 17 Shtator, 2019



25 vjet "Oda dibrane"

• Në këtë festival si për çdo vit mori pjesë edhe grupi folklorik i qendrës kulturore Bulqizë. Këtë vit atij ju bashkuan edhe grupe valltarësh nga zona e Martaneshit dhe ajo e Gollobordës të cilët performuan valle me motive të zonës së tyre si dhe kostumet e larmishme që përdorin

Për tre ditë me radhë, në datat 3, 4 dhe 5 Tetor është zhvilluar edicioni i 25-të i festivalit Oda Dibrane. Më shumë se 25 grupe me rreth 650 artistë mbushën rrugët e Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe për tre ditë me radhë. Oda Dibrane është festivali folklorik më i madh që zhvillohet në trevat Shqiptare. Në këtë festival marrin pjesë artistë nga të gjitha trevat Shqipërie, dhe nga shtete të ndryshme. Ky festival është i veçantë pasi mbahet në dy shtete. Në Peshkopë (Shqipëri) dhe në Dibër të madhe në Maqedoninë e Veriut). Këtë vit për të përshëndetur ishte ansambli shtetëror i Maqedonisë. Profesori i muzikës në Universitetin e Tetovës Jeton Pustina, anëtar i Jurisë, tregon se si u rrit Oda Dibrane dhe sot numëron 25 vite. Ai ka luajtur në edicionin e parë si kitarist, më pas ka qenë pjesëmarrës si drejtues i ansamblit të Tetovës, dhe sot si anëtar Jurie. Koreografi i Ansambilit të Shtetit Shqiptar Gëzim Alimehmeti, vlerëson prurjet e Reja nga grupet konkurrese, pjesëmarrjen e të rinjve dhe kostumografinë e larmishme. Ky festival që nga krijimi ka menduar të risjellë në kohë folklorin e bukur, ritin, alegorinë, këngën alegorike të trevave apo zonave nga vijnë artistët, dhe këtë qëllim e ka arritur më së miri, duke i qëndruar peshës së kohës, ai sot është në vitin e 25-të Prof.dr. Isak Shehu dekan i fakultetit të muzikës në Tiranë thotë se janë kriteret strikte që Oda Dibrane ka vendosur nga fillimi që e kanë mbajtur, por edhe grupet e përzgjedhur me kujdes kanë bërë që publiku ta mbështesë maksimalisht. Për të përshëndetur në 25 vjetorin e Odës Dibrane këtë vit ishte Ansambli shtetëror i Kosovës "SHOTA", i cili performoi përpara publikut artdashës Dibrane, gjatë kohës që juria merrte vendimin për çmimet. Në fund në natën e tretë juria ndau disa mirnjohje për artistë, grupe apo këngë të ndryshme. Çmimin e parë e fitoi ansambli i Rugëvës nga Kosova,



çmimin e dytë e fitoi Ansambli nga Mati, ndërsa çmimin e tretë e fitoi ansambli nga Reka e Epërme në Maqedoni, i cili u vlerësua edhe për kostumografinë. Drejtori i festivalit Veli Vraniçi tregon sa vështirë është të mbash një festival të tillë të këtyre përmasave.

Në këtë festival si për çdo vit mori pjesë edhe grupi folklorik i qendrës kulturore Bulqizë. Këtë vit atij ju bashkuan edhe grupe valltarësh nga zona e Martaneshit dhe ajo e Gollobordës të cilët performuan valle me motive të zonës së tyre si dhe kostumet e larmishme që përdorin.

Garues në festivalin mbarëkombëtar "Oda dibrane" 2019 ishte edhe ansambli "Mati", i cili performoi natën e dytë të këtij festivali që u mbajt në pallatin e kulturës "Haki Stërmilli" në Peshkopë.

ODA DIBRANE KA QENË PORTA E PARË HYRËSE E SHQIPTARËVE NGA MATANË KUFIJVE PËR NË SHQIPËRI

Këtë vit, festivali Oda Dibrane zhvilloi edicionin e 25-të. Kjo jetëgjatësi e

vazhdueshmëri ka ardhur për shkak të vlerave që sjell.

Oda Dibrane e ka zhvilluar edicionin e parë të saj në vitin 1994. Ishte një iniciativë e përbashkët e artistëve dibrane dhe e Shoqatave Kulturore artistike të shqiptarëve të Maqedonisë që kishin nevojë për më shumë hapësira për jetën e tyre artistike.

Ky festival, që nga ajo kohë, vazhdon pa ndërprerje. Edhe në vitin 1997, ky festival dha shprese në atë kohe se jeta vazhdonte.

Oda Dibrane në gjuhën popullore simbolizon dhomën e pritjes së mikut. Ajo është simbol i vatrës së besës e bujarisë, qëndresës e trimërisë së shqiptarëve, ku bëheshin dasma e kuvende, ku shpalosej urtësia e mençuria e këtij populli.

Oda ka shërbyer ndërkohë dhe si vendi ku thureshin e merrnin udhë këngët e bukura epike e lirike, ku pritej e përcillej miku i shtëpisë, ku përdorej fjala e urtë e dialogu alegorik.

Në këtë "Odë", fjala kishte peshë

shumë të rëndë. Jo më kot thuhej se: "kur të shkosh në odën e Dibrës duhet të marrësh me vete një metër, një kandar dhe një gjilpërë".

"Unë kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, por mbarova dhe një Universitet të dytë, atë të Dibrës", ka shkruar studiuesi anglez Riginald Hibbert në gazetën "Albania Life".

Festivali "Oda Dibrane" ka si qëllim të parë të bashkojë artistët shqiptarë, pavarësisht kufijve, me idenë që Oda Dibrane të jetë mikpritëse e Odës Shqiptare.

Është një takim specifik, original në llojin e vet, jo vetëm në Shqipëri, por dhe më gjerë. Është takim i këngës e valles humoristike, riteve e lojërave popullore. Qëllimi është t'i rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, t'i sjellë në kohë e t'i bëjë të asimilueshme për publikun e kohës.

Specialistët më të mirë në këtë fushë e kanë quajtur këtë festival një zbulim dhe kontribut të çmuar në traditën e kulturën shqiptare, si festivali më i rëndësishëm në Shqipëri në fushën e traditës, pas atij të Gjirokastrës.

-Në shkallë kombëtare pasuron me originalitet larminë e evenimenteve artistike që zhvillohen në vendin tonë

-Bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare për të promovuar një mozaik të pasur të trashëgmisë kulturore, artistike, folklorike.

-Pasuron jetën kulturore artistike të qytetit të Peshkopisë, duke edukuar në brezat e rinj thellësinë e mendimit të "shkollës së Dibrës" mikpritjen, bujarinë, artin fin të fjalës, të këngës e valles dibrane.

Festivali "Oda Dibrane" për seriozitetin e organizimit dhe të zhvillimit gëzon statusin e respektuar të 25 viteve.

Në këto 25 vite kanë marrë pjesë mbi 130 grupe e shoqata artistike. Kanë interpretuar mbi 8 000 artistë.

Të gjithë emrat e shquar të artistëve popullore të trevave shqiptare kanë marrë pjesë në këtë festival. Që nga i mirënjohuri, artisti dibran Hazi Ndreu e me radhë Ndue Shyti, Frok Haxhia, Bujar Qamili, Ilir Shaqiri, grupi çam, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi; grupet polifonike shoqëritë artistike e kulturore nga Vlora, Saranda, Gjirokastro, Berati, Fieri; Korça, Kukësi, Puka, Lushnja, Elbasani, Shkodra, Kolonja, Prishtina, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Kumanova, Tetova dhe e gjithë Maqedonia, Ulqini, Presheva, Medvegja e Bujanovci etj.

Nuk ka trevë nga Shqipëria apo trojet shqiptare përtej kufirit që nuk ka marrë pjesë të paktën një herë në "Odën Dibrane".

Oda Dibrane ka qenë porta e parë hyrëse e shqiptarëve nga matanë kufijve për në Shqipëri.



Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta mori pjesë në Simpoziumin Shkencor: “110 vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar”

simpoziumi

Meta: Dibra, epiqendër

• 13 Shtator 2019 - Presidenti Meta vlerëson Shoqatën “Bashkësia Dibrane” dhe personalitete të shquara të kësaj treve atdhetare: Malet e Dibrës ngelen përherë bastioni dhe barrikatat e para të betejave për liri e pavarësi

Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta mori pjesë në Simpoziumin Shkencor: “110 vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar”, që u zhvillua në ambientet e Akademisë së Shkencave.

Me rastin e këtij jubileu historik, në prani të përfaqësuesve të jetës politike, akademike, shoqërore dhe kulturore të vendit, të bashkësisë dibrane të Tiranës, të Komunës së Dibrës së Madhe dhe nga diaspora, Presidenti i Republikës dekoroi me Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” Shoqatën “Bashkësia Dibrane” me motivacionin: “Për kontributin e shquar dhe atdhetar në ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e traditës dibrane, në veçanti të vlerave të Dibrës së Madhe, si dhe bashkësisë tradicionale dibrane në Tiranë”.

Gjithashtu Presidenti Meta vlerësoi disa personalitete të shquara të bashkësisë dibrane: me Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” (pas vdekjes): arsimtarin, atdhetarin dhe humanistin Faik Shatku (Dibra); politikanin, diplomatit dhe intelektualin e spikatur në fushën e pedagogjisë Luan Hajdaraga; ndërsa me Titullin “Mjeshtër i Madh” hidroteknikun, humanistin dhe aktivistin shoqëror zotin Faik Bruçi dhe mjekun, kontribuesin në fushën akademike dhe universitare zotin Petrit Bara.

Në fjalën e Tij përshëndetëse, Presidenti Meta ndër të tjera vuri në dukje se: “E vendosur nga fati i kohërave midis tre shteteve në Ballkan, ajo i dhuron secilit kënaqësinë për të pasur një bashkësi vlerash autentike si ato të dibranëve.

Por, në fakt ajo mbeti epiqendër e shqiptarizmit! Mbijetesa e dibranëve është e lidhur ngushtë me mbijetesën e gjithë kombit shqiptar.

Kjo qëndresë e përbashkët i ka rrënjët tek shkalla e lartë e atdashedurisë, solidariteti, sakrificat, përkushtimi dhe kontributi i gjithë brezave dibranë ndër shekuj.

Forca e ndjenjës kombëtare dhe dëshira për të ndërtuar vetë fatin e tyre janë nga tiparet kryesore të dibranëve”

DIBRANËT JANË NDJERË PËRHERË BALLËLARTË DHE KRENARË PARA HISTORISË

Në fjalën e tij në Simpoziumin Shkencor: “110 vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar”, Presidenti Meta tha se Dibranët janë ndjerë përherë ballëlartë dhe krenarë para historisë. Kjo sipas tij për faktin se nuk ka etapë të luftës për liri të kombit shqiptar që ata të mos kenë gjurmët e kontributit të tyre.

“Treva e Dibrës me nëntë malet e saj të lartë ka qenë në shekuj kështjella natyrale e lirisë së shqiptarëve.



Malet e Dibrës ngelen përherë bastioni dhe barrikatat e para të betejave për liri dhe pavarësi. Në epopenë e lavdishme të Skënderbeut, treva e Dibrës luajti një rol gjeostrategjik të rëndësishëm në fitoret kundër pushtuesve osmanë. Jo rastësisht, shumicat e betejave Skënderbeu i zhvilloi dhe i fitoi në trojet e dibranëve. Çdo dibran ishte një luftëtar i Skënderbeut.

Emrat e fushë betejave si Torvion, Sfetigrad, Oranik, Çidhen, Vajkal, etj., u bënë të njohura për gjithë Evropën dhe më tej.

Kontributi njerëzor dhe sakrificat e dibranëve kanë qenë biblike sikurse betejat e Skënderbeut.

Disa nga kapedanët më të shquar të heroit tonë kombëtar ishin dibranët: Pal Kuka, Vladan Gjurma, Moisi Golemi e Zakaria Gropa, si dhe shumë komandantë nga gjiri i popullit.

“Skënderbeu pritej me brohori dhe përfaqime në çdo cep të Dibrës. Ai u mbështet në çdo betejë si biri dhe vëlly i tyre”, – thekson historiani Kristo Frashëri në një nga librat e tij më të mirë për historinë e Dibrës...

Dibra, dhe veçanërisht malet e saj ngelen në shekuj treva e panështruar prej pushtuesve.

Gjatë sundimit otoman, dibranët nuk e ndalën luftën për liri.

Ata mbështetën lidhjen e Prizrenit dhe u bënë organizatorët e Kuvendeve të mëdha të maleve të cilat u drejtuan nga atdhetarët Iljaz pashë Dibra, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Isuf Karasani, Ramiz Daci, e shumë të tjerë.

Në 28 Nëntor të vitit 1912 ata ishin mbrojtës të flaktë të aktit të Pavarësisë dhe Qeverisë së Ismail Qemalit me dy nga përfaqësuesit më të shquar të saj, si Vehbi Dibra dhe Nikoll Kaçorri.

Përpjekjet e dibranëve për liri nuk reshtën edhe pas shpalljes së Pavarësisë.

Grykat e famshme të maleve të Radikës e Drinit të Zi ngelen përherë

tuar në dy Brigada dhe shumë çeta, ata i falën atdheut 176 Dëshmorë dhe 6 Heronj të popullit”,-tha kreu i shtetit shqiptar

TRASHËGIMI KRENARË E CIVILIZIMIT TË BANORËVE TË DIBRËS

Duke përshëndetur pjesëmarrësit në Simpoziumin Shkencor: “110 vjet



porta të hapura për miqtë dhe fusha betejash për pushtuesit.

Dibranët në vitet e Luftës së Parë Botërore do të shënonin faqe të ndritura lavdie e sakrificash në luftën kundër pushtuesve serbë.

Të panumërta janë betejat dhe përpjekjet e dibranëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Të rresh-

Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar”, Presidenti Meta evokoi dy cilësi të civilizimit dibran, sikurse janë organizimi i Kuvendeve, që kemi aq shumë nevojë sot, si dhe rregullat kanunore emancipuese të trevës së Dibrës.

“Edhe pse kanë kaluar shekuj, tiparet, traditat, cilësitë, si dhe struk-

simpoziumi

Presidenti Meta vlerësoi rolin e shoqatës “Bashkësia Dibrane” në promovimin e vlerave më të spikatura etno-kulturore, historike dhe patriotike të kësaj bashkësie.

e shqiptarizmit



• *“Edhe pse kanë kaluar shekuj, tiparet, traditat, cilësitë, si dhe struktura e bashkësisë krahinore dibrane përcjellin edhe sot mesazhe dinjiteti, përgjegjshmërie, emancipimi dhe intelektu të veçantë popullor.*”

tura e bashkësisë krahinore dibrane përcjellin edhe sot mesazhe dinjiteti, përgjegjshmërie, emancipimi dhe intelektu të veçantë popullor.

Në kushtet e okupimit të huaj, Kuvendet dibrane ishin parlamentet e kohës. Demokracia vendore e ditëve tona do të gjente pasqyrimin për shekuj me radhë në odat e burrave, kuvendet e maleve, besëlidhjet, kuvendet e fisit, e deri te kuvendet ndërkrainore.

Shkalla e lartë e demokracisë në Kuvendet dibrane është edhe sot një trashëgimi krenare e civilizimit të banorëve të kësaj treve.

Përsosmëria në organizim, barazia, respektimi i dialogut, mënyra demokratike e vendimmarrjes, sjellja e kulturuar ndaj kundërshtarëve dhe për më tepër zbatimi korrekt i vendimeve përbëjnë një shembull të lartë integriteti etiko-moral”, -u shpreh Presidenti Meta.

Nga rregullat kanunore i veçoi: ‘Falja e gjakut’ përballë interesave madhore dhe ‘Lidhja e Besës’ para pushtimit dhe kërcënimit të huaj. Sipas kreut të shtetit, këto gjeeste fisnike e atdhetare të dibranëve në Kuvendet e Maleve janë edhe sot një mesazh kuptimplotë për klasën politike dhe shoqërinë shqiptare.

DIBRANËT, PËRHERË TË BASHKUAR DHE PA DALLIME FEJE E KRAHINE

Para fateve dhe sfidave të kombit, dibranët kanë qenë përherë të bashkuar dhe pa dallime feje e krahine.

“Përherë shqiptarët kanë përdorur gjuhën e arsyes përpara se të rrëmbenin armët. Kuvendet e Dibrës shpallorin aftësitë e shqiptarëve për të përdorur dijet e tyre, diplomacinë, forcën e logjikës, kulturën popullore të debatit, si dhe argumentet e një sho-

qërie që aspiron liri e pavarësi.

Kështu 110 vite më parë, në Dibër, u manifestua forca dhe vullti i lëvizjes kombëtare shqiptare në një prej Kuvendëve më delikate që ndante historinë.

Patriotët dibranë ia dolën të dësh-tonin përpjekjet e xhon turqve, në një kuvend të thirrur prej tyre, për të bindur shqiptarët të quheshin pjesëtarë të kombësisë osmane dhe të shkruanin gjuhën amtare në alfabetin arab.

Ky akt i tyre ishte një triumf i doktrinës së rilindjes kombëtare për pavarësi, një mbështetje e Kongresit të Manastirit dhe vendimeve të tij, si dhe një tregues i aftësisë vetëqeverisëse dhe dëshirës për liri të gjithë shqiptarëve”, -tha Presidenti i Republikës Sipas numri një të shtetit shqiptar, historia, figurat dhe vlerat e dibranëve janë aq të shumta sa nuk mund t’i përmbledh dot në një fjalë përshëndetëse.

Në këtë kontekst Presidenti Meta vlerësoi rolin e shoqatës “Bashkësia Dibrane” në promovimin e vlerave më të spikatura etno-kulturore, historike dhe patriotike të kësaj bashkësie.

“E ndjek prej kohësh aktivitetin e shoqatës, përpjekjet e saj për mbajtjen gjallë të kulturës, qytetarisë, trashëgimisë historike dhe traditave të trevës dibrane. Gëzohem që shumë personalitete të spikatur të shoqatës suaj, mbështesin dhe nxisin krahas vlerave shpirtërore-historike edhe projektet aktuale ekonomike e sociale të zhvillimit, si edhe bashkëpunimin me rajonet fqinje të Dibrës.

Për sa më sipër, gjithashtu do të doja sot t’i akordoja Shoqatës “Bashkësia Dibrane” Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”.

Kam kënaqësinë gjithashtu të falënderoj shoqatën tuaj të nderuar për propozimet, për të vlerësuar me

Titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” Profesorin e nderuar dhe të paharruar, Luan Hajdaraga, atdhetarin e shquar Faik Shatku dhe si dhe me Titullin “Mjeshtër i Madh” Prof. Dr. Petrit Bara dhe z. Faik Bruçi”. Ndërkohë Presidenti Meta shprehu bindjen se panteoni i vlerave dibrane ka edhe shumë figura dhe personalitete të spikatur. Për këtë arsye, ai tha se



do të mirëpres edhe në të ardhmen bashkëpunimin me të gjithë drejtuesit e Shoqatës “Bashkësia Dibrane” për të vlerësuar të gjithë personalitetet e shquara të historisë të jetës publike dhe kulturore të Dibrës.

Nga Korabi krijon një vizion më strategjik.

Jo për Dibrën e Shqipërinë, por për të gjithë rajonin

Duke përshëndetur pjesëmarrësit në Simpoziumin Shkencor: “110 vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje historike për kombin shqiptar” Presidenti Meta ndjehet shumë i lumtur që është ngjitur në majën e Korabit, sepse nga Korabi krijon një vizion më strategjik. Jo për Dibrën e Shqipërinë, por për të gjithë rajonin.

“Pasi shkova në Korab mësova dy gjëra. E para, mësova që Korabi nuk ka vetëm majën më të lartë, por ka 3 ose 4 majat më të larta të Shqipërisë e pastaj vjen Jezerca.

Së dyti, mësova diçka tjetër për të cilin u habita, kur lexova atje 2764 metra, sepse ne e kemi lexuar gjithmonë shifrën 2751 metra i lartë. Pra, Korabi ishte “rritur” kështu që kjo është shen-

jë e mirë, sepse më mirë të rritet mali se sa të zbrësë, aq më tepër që edhe unë vij nga një trevë malore dhe kam dëgjuar shpesh atë urimim që bëhet ‘malet tona më të larta’.

Kështu që ju uroj juve, i uroj Dibrës dhe gjithë shqiptarëve malet më të larta! Faleminderit!”, përfundoi përshëndetjen e tij Presidenti I Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Për Kongresin e Manastirit dhe

PROF. BAJRAM XHAFA

Kongresi i Manastirit para 111 vjetësh dhe ai i Dibrës para 110 vjetësh, patën si objekt kryesor çështjen e alfabetit. Vendimi që morën për Alfabetin Latin për shkronjat shqipe, përbën një akt revolucionar që “shpejtonte” rrugën drejt pavarësisë. Këtë vlerë askush nuk e ka vënë dyshim, dhe nga historiografia ka pasur vlerësimet më të larta në çdo kohë. Për historinë e alfabetit kanë shkruar shumë nga studiuesit tanë. Alfabeti latin nënkuptonte dhe një identitet “kombëtar”, “evropian” ose “perëndimor” dhe, deri identitet “latin”. Një analizë të hollësishme për këtë problem ka bërë studiuesja franceze Natali Klejer tek vepra “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar-Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë”. Me këtë vendim, Shqipëria u “çlirua” nga harfet arabe dhe kompleksi aziatik. Kjo i voliste edhe teknikës (evropiane) së shtypshkrimit. Ky akt u konsiderua dhe konsiderohet si provë e pjekurisë politike të shqiptarëve. Tre vjet më vonë, në Shqipëri ja mbërriti Pavarësia.

Me gjithë çertifikatën e lartë të futjes së alfabetit latin, historia e mëpastajme e Shqipërisë dhe e shqiptarëve përbën një kalvar të vërtetë. Domethënia e këtij akti, përmbysja revolucionare e së vjetrës “anadollake, turkomane e aziatike” dhe “hapja” drejt Evropës ka dhe një anë tjetër të medaljes: një kapak hekuri për të mbyllur gjithë trashëgiminë e shkruar historike e kulturore shqiptare të periudhës osmane. Një fshirje të kësaj historie. Këtu do të rrekem ndopak edhe unë.

Duke përjasur historinë e Japonisë me atë të Turqisë, të cilat në fund të



shek. XIX dhe fillim të shek. XX për ardhmërinë kanë pasur gjasa pothuajse të barabarta, Alija Izetbegović shkruan se Japonia është orvatur t'i unjsojë traditat me progresin, ndërsa modernistët e Turqisë zgjodhën rrugën e kundërt. Dallimi në filozofinë e reformatorëve japonezë dhe turq, mbase nuk ka qenë askundë aq i qartë, aq karakteristik sa në çështjen e alfabetit.

Derisa Turqia e abrogoi alfabetin arab (1928), i cili për nga thjeshtësia e tij me vetëm 28 shenja, bën pjesë ndër alfabetet më të përkryera dhe më të përhapura botërore, Japonia refuzoi kërkesën e romajve të vet që të aplikojë alfabetin latin. Ajo mbajti alfabetin e vet të komplikuar, i cili, pas reformës,

përveç 46 shenjave përmban edhe 880 ideograme kineze. Megjithatë sot shohim se ku është Japonia e ku Turqia.

Shpejt u bë e qartë se nuk ishte fjala vetëm për alfabetin si mjet i thjeshtë i regjistrimit. Shkaqet e mirëfillta, e pastaj edhe pasojat, janë shumë më të thella dhe më të rëndësishme. Esenca e tërë qytetërimeve dhe e progresit njerëzor është në vazhdimin, e jo në shkatërrimin dhe mohimin, shkruan Izetbegović.

ALFABETI ËSHTË MËNYRË ME TË CILËN POPULLI MBAN MEND DHE JETON NË HISTORI

Me eliminimin e alfabetit arab e

tërë pasuria e së kaluarës, e ruajtur me fjalën e shkruar, për Turqinë, (kjo vlen edhe për Shqipërinë, B. Xh.) ka qenë kryesisht e humbur dhe ajo me këtë veprim të vetëm është bastarduar deri në kufijtë e barbarisë. Krahas një varg reformash të tjera paralele, (për Shqipërinë bëhet fjalë për revolucione), brezi i ri turk (dhe shqiptar) u gjet pa mbështetje shpirtërore dhe në një llojë vakuumi shpirtëror. Turqia ka humbur kujtesën e saj, të kaluarën e saj. Po ashtu edhe Shqipëria? Kujt i nevojitej kjo? Në këtë kuptim, ky akt ka qenë një atentat kulturor, me synime të largëta.

Grekët, serbët, rusët vazhdojnë të ruajnë me fanatizëm alfabetin e vjetër cirilik, madje e mbajnë si të “shenjtë”, ndërsa përfaqësuesit e modernizmit në botën islame në përgjithësi dhe atë shqiptare në veçanti, nuk kanë qenë, pra, ai lloj i njerëzve të mençur popullorë, të cilët kanë ditur në rrethana të ndryshuara dhe në mënyrë të re t'i realizojnë idealet dhe vlerat e vjetra. Ata janë ngritur kundër vlerave dhe shpesh me cinizëm të ftohtë dhe miopi të tmerrshme i kanë shkelur shenjtëritë popullore dhe e kanë shkatërruar jetën reale, që në vend të saj ta rimbjellin imitimin e jetës. Si pasojë e kësaj furie, ...janë krijuar, ose janë në rrugë të krijohen, kombet-plagiante (nënvizimi im), me shartesa: vende shpirtërisht të trazuar, pa fizionomi vetjake dhe pa ndjenjë për jetën vetjake. Në këto vende, shkruan A. Izetbegović, çdo gjë është joautentike dhe artificiale, pa entuziazëm dhe fuqi të vërtetë, sipas shembullit të shkëlqimit të rrejtshëm të qyteteve të tyre të evropianizuara. Dibra e Madhe është viktima më e gjallë e këtij agresioni të fshehtë e të hapur.

Shto këtu faktin se historia e mbi 150 vjetëve të fundit për shqiptarët është histori e shfarosjes së pandërprerë të tyre nga sllavo-grekët ortodoksë me masakra, spastrime etnike dhe genocid, asimilimin me dhunë dhe e një lloj “klonimi” ku në të ashtuquajturin “Ballkan Perëndimor”, një eufemizëm për të zëvendësuar emërtësën Shqipëria Lindore, me brumin shqiptar u mveshën a krijuan popuj, shtetet e “kombet” maqedonas, malazezë, apo iu shtuan popujve grekë e serbë. Shembulli më i fundit është ai i Maqedonisë Veriore së cilës mezi i “gjetën” emrin. Ndryshimet demografike në “Ballkanin Perëndimor” u bënë tërësisht në kurriz të shqiptarëve.

Ç’kuptim ka pasur pavarësia e një vendi (mysliman) dhe si e kanë përdorur ata këtë liri?

Me pranimin e modeleve të huaja ideore dhe të politikave të tyre; me kërkimin e mbështetjes politike te të huajt, qoftë tek ata në Perëndim ose tek ata në Lindje, çdo njëri nga këto vende, vullnetarisht, në gojën e sunduesve të rinj, ka pranuar robërimin e sërishëm: filozofia e huaj, mënyra e huaj e jetës, ndihma e huaj, kapitali i huaj, përkrahja e huaj. Pavarësia është reduktuar në himn dhe flamur.

Për shqiptarët ky qe edicioni i parë i modernizmit kulturor me anë të alfabetit, të evropianizimit e të “latinizimit” të tyre. Kështu, Historia e Shqipërisë humbi “lidhjet” historike 500 vjeçare. Myslimanizmi shqiptar bëri shkëputjen e parë të fortë nga Libri i shenjtë, Kurani. Hiquani myslimanëve Kurani dhe pastaj nuk ka nevojë t'i luftosh ato me

(Vijon në faqen 9)

“Shqiptarët luftojnë ‘për mbret e troje të veta’ e ‘të bardhën fe’”

MUSTAFA KRUIA: Pse s'kanë dashun pushtetet othomane që edhe Shqiptarët të kenë shkollat e veta në gjuhë të vet si gjithë popujt e tjerë allogjenë të mbretnisë? Pyet Margjokaj. Unë e kuptoj kështu, përgjigjet Mustafa Kruja: Çdo e drejtë ka konsistencë kur njeriu që duhet t'a ketë e ndien, e din e e çmon. Ndryshe e drejta nuk ekziston. E kanë ndiem, e kanë kuptuem, e kanë çmuem Shqiptarët të drejtën për shkollat shqip? Njëqindmijë jo, një po: domethanë jo.

Na s'kemi pasun kurrë, jo shkolla, por as shkrim t'onin. Kur një elite të vogël i ra ndër mend për të aty kah 1870 e sa, i pari alfabet shqip u sajue shi në Stamboll me lejen e Sulltanit. Gjithash-tu u çel edhe një shkollë shqip në Korçë. Shqiptarët nisën me shkruem. Në mos gabofsha – se s'kam burime për me kontrolluem hollësitë – në 1880 u botue e famshmja “Histori” e Skënderbeut prej Neim Frashërit. Grekët u nxituen me ia raportuem fill e për pe Sulltanit. Dhe kishin ç'i raportojshin! Se ajo s'ishte as histori, por një libello që shfrente kundra Turqet vnerin e 400 vjete të një populli të pushtuem ashtu siç e ndiente, jo vetë ai popull, por auktori.

Pruna vetëm një shembull, por në letërsinë gojore, të botueme përjashta,

ke sa të duesh edhe tjerë që tregojnë se ç'synojshin intelektualët shqiptarë, se ku dojshin me dalë nëpër shkollat kombtare në gjuhën shqipe. Sikur shkrimi shqip, letërsia shqipe të kishte pasë nisun e vazhduem me vepra si Lahuta e Malcisë në të cilën shqiptarët luftojnë “për mbret e troje të veta” e “të bardhën fe”, kush mundet me thanë se na nuk do të kishim pasun shkollat t'ona në gjuhën t'onë, librat t'anë e gazetat t'ona, jo vetëm lirisht, por edhe të nxitun e të subvencionuem prej shë subvencionuem prej shteti othoman?...

Unë e kam besuem gjithmonë se ndër Shqiptarë isintinkti racia ka qenë ma i fortë se ndiesia fetare, por jo “interesa kombtare”, të cilën ata s'e kuptojnë as sod. (M. Kruja, “Letërkëmbim, f. 326)

Samiu tërheq vemendjen edhe në faktin se nuk u shkrua gjuha shqipe dhe në faktin se nuk u shkrua gjuha shqipe dhe për këtë kritikon...Po Ptolemejtë q'ishin fjeshtë nga Çamëria...që zgjuan dituritë e gjuhën e greqvet n'Aleksandrie, qysh nuk e menduanë edhe njëherë për gjuhën e tyre, t'i bënë një palë shkronja...” B. Xh. “Historia shqiptare”, “Rozafat”, Shkodër, 2010, f.88).

Një akt të tillë revolucionar bëri 20 vjet më vonë (1928) Qemal Ataturku në Turqi, futi në përdorim alfabetin latin

duke zëvendësuar atë arab.

Samiu në radhë të parë vendosi arabët, duke shënuar se janë populli më i madh dhe më madhështor, për të përfunduar, sepse islami është shfaqur në atë mjedis dhe Pejgamberi a. s. ishte prej tyre, prandaj atyre u takon nderi e respekti mbi të gjithë popujt myslimanë. (S. Frashëri, “Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit”, LOGOS-A, 2003, f. 15)...Arabët kanë një karakteristikë të veçantë: e arabizojnë cilindo që takohet me ta. Por askush s'mund t'i bëjë ata joarabë (f. 35). Koncepti i Samiut për mësimin e arabishtes në radhë të parë si gjuhë e fesë Islame është i paprekur. Në rëndësinë e saj Samiu shihte një titull krenarie. Ai shkruan plot bindje: Mësimi i saj është i domosdoshëm për cilindo dijetar (f. 16), gjuha arabe është gjuha e Islamit (f. 3). ▽

**Materiali u kumtua në veprimtarinë e organizuar nga Shoqatës Atdhetare e Kulturore “Bashkimit Dibran” Tiranë me 13 shtator 2019 me rastin e 110 vjetorit të Kongresit të Dibrës të 24 korrikut 1909 të zhvilluar në Sallën e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave. Ishte i pranishëm edhe Presidenti i Republikës Ilir Meta si dhe kryetari i komunës së Dibrës së Madhe, dr.Hekuran Duka*

të Dibrës të para 100 vjetëve

(Vijon nga faqja 8)

armë apo mjete të tjera, thoshte Dizraeli. Kjo qe si paradrženie para se të shpallej pavarësia. Të tjerat do të vinin më pas.

Mund të pyetet: çfarë mund të bëhet sot? Ta kthejmë historinë mbra-pa? Padyshim, ajo që u bë para 100 vjetësh nuk mund të kthehet. Alfabeti latin u ngjiti, u bë "përvojë historike", traditë e trashëgimi historike, u fosilizua. Boshllëku duhet mbushur nëse i lëmë fushë të lirë asgjësimit si popull e si komb. Shqiptarët duhet t'i mëshojnë rimëkëmbjes së nacionalizmit dhe forcimit të besimit fetar, sidomos asaj islame.

Edicioni i dytë: Gjysmë shekulli pas ndryshimit të alfabetit kemi fjalën e 6 Shkurtit 1967 të Enver Hoxhës e cila, me fshehtësi të hekurt fshiu nga faqja e dheut (të Shqipërisë politike, komuniste) kishat, xhamiat dhe besimin në Zot. Myslimanizmi, shpëtimtari i etnisë shqiptare, e pësoi më rëndë, sepse ai



mbeti krejtësisht i izoluar, pa asnjë lindje e mbështetje. Kurani, libri i shenjtë i myslimanëve u zhduk. Ky qe një përshkallëzim tjetër në procesin e përmbysjes së historisë së vërtetë të shqiptarëve dhe të islamizmit ndër shqiptarët.

Edicioni i tretë, që t'i lidhim nyjat e historisë me fillin e kuq marksist-leninist apo fillin e zi evropianist e t'i marrim shkallë-shkallë. Me rënien e komunizmit, krishtërimi shqiptar e pati të lehtë rimëkëmbjen; - kishte mbështetjen e Evropës dhe të fqinjëve, madje kaloi në revansh. Për "infrastrukturën" dhe pasurimin e tij të mëtejshëm ishte punuar me programe të posaçme. Ndërsa Islami, me shpalljen e lirisë së fesë u sulmua, u anatemua, u denigrua; u shpall "fundamentalist", agresiv e i rrezikshëm. etj. etj.

Këtë e kuptoi mirë së pari Ramiz Alia, presidenti komunist i Shqipërisë postdiktatoriale (në fakt ai(ose qe i mësuar me kohë dhe e dinte fort mirë lojën qysh në gjenezë), prandaj, para se të bënte dorëzimet, na solli në Shqipëri një Paleolog, jo paleontolog, një "dinast" i rënë nga historia para 500 e kusur vjetësh, mbeturina e fundit e Perandorisë Romake të Lindjes (Bizantit), që t'u hapte shqiptarëve vizione dhe iluzione ortodokse e krishtërie. Më pas Fatos Nano, kryeministri komunisto-socialist i "tranzicionit", shpалosi hapur objektivin e vërtetë duke hedhur tezën e lëshuar direktivën si "udhëheqje për veprim" të zhdukjes së 555 vjetëve të historisë së Shqipërisë.

Ç'ka nënkuptonte përmbysjen dhe fshirjen nga faqja e "dheut" të historisë së periudhës osmame, pikërisht atë

periudhë kur u ringjall e u mëkëmb raca iliro-shqiptare dhe u formua kombi shqiptar me tiparet që ka sot. Kthimi i historisë shqiptare në mesjetën klasike do të shoqërohet sipas atij plani, me kthimin e popullsisë shqiptare në latinizëm, në ortodoksizëm dhe konvertimin e myslimanëve shqiptarë në fenë e të parëve, dmth, në të krishterë. Klonimit ideologjik marksist leninist do t'i zinte vendin klonimi fetar.

Starti i parë për groposjen e historisë kombëtare dhe të fesë islame ndër shqiptarë ishte ndryshimi i alfabetit. Direktivat e mëvonshme për "reforma" do të ishin një vazhdimësi që do ta thellonin shkëputjen e historisë nga tabani dhe trashëgimia historike e bashkëjetesës shqiptaro-osmane.

Sot ka ardhur në Shqipëri arkivi i Stambollit apo një pjesë e tij që shqiptarët të shohin e të njohin historinë tyre të vërtetë, por pasojat e shkëputjes drastike do të ndjehen. Për t'u bërë i përdorshëm duhen programe kombëtare për të përparësitë specialiste, osmanistë. Vetëm atëherë mund dhe do të bëhet "zbardhja e shumë ngjarjeve dhe disa personaliteteve që njihen si ikona të historisë dhe e disa të tjerëve që njihen si njolla të zeza në historinë tonë.

Në rrjedhjen e kësaj ecurie të rendjes sonë drejt "progresit", vjen pyetja: Ku ishim? ku jemi? ku vemi-?

"O Allah kërkoj mbrojtjen tënde nga këto katër gjëra: nga dituria që nuk sjell dobi, nga zemra që nuk frikësohet, nga nefs i që nuk ngopet dhe nga duaaja që nuk pranohet". Hadith Sherif.

AKTUALITET

700 nxënës të shkollës 9-vjeçare "Sh. Tançi" e nisën mësimin me shkollë të re



Ashtu si në të gjithë vendin edhe në rrethin e Bulqizës janë çelur dyert e shkollave për Viti i ri shkollor 2019-2020, për 4600 nxënës.

Nga një investim i dhënë nga Qeveria Shqiptare këtë vit rreth 700 nxënës të shkollës 9-vjeçare "Shefqet Tançi" në Bulqizë, do të kenë mundësinë të zhvillojnë mësim në kushte optimale. Me një investim prej 80 milionë lekë të rinj kësaj shkolle ju bë një rikonstruksion total, përfshirë shtimin e ngrohjes dhe ambientet sportive.

Kjo godinë arsimore ju nënshtroa një rikonstruksion total me një vlerë prej 80 milion lekë të rinj, financim ky i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Lefter Alla tha se tashmë shkolla ofron kushte mjaft komode për zhvillimin e një procesi mësimor-edukativ me standarde. Në rikonstruksionin e shkollës është përfshirë edhe baza e re materiale, duke krijuar kështu kushte mjaft të mira për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Për shkak të nisjes së rikonstruksionit, vitin e kaluar 650 nxënës mësonin turn i dytë në shkollën 9-vjeçare të Lagjes së Vjetër të Bulqizës. Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Lefter Alla pasi bëri inaugurimin e shkollës, u shpreh se nxënësit e kësaj shkolle do të zhvillojnë mësim në ambiente moderne, ai në fjalën e tij pasi uroj nxënësit u kërkoj atyre që ta mirëmbajnë sa më mirë. Prindërit të cilët kanë fëmijët e tyre në këtë shkollë u shprehën mjaft të kënaqur nga investimi që është bërë kësaj shkolle. Për vitin e ri shkollor në rrethin e Bulqizës kanë nisur mësimin për here të parë 400 nxënës. Mes emocioneve mësuësja e klasës së parë Lindita Rexhepi uroi nxënësit të cilët u ulën për herë të parë në bankat e shkolles.

Bulqizë, mbyllet shkolla e parë shqipe. Banorët në protestë

Banorët e fshatit Homesh në Njësinë Administrative Shupenzë të Bashkisë Bulqizë kanë protestuar para shkollës fillore "Ramiz Manjani" për mbylljen e shkollës së tyre. Sipas TV Bulqiza, shkak i kësaj proteste ka qenë transferimi i fëmijëve nga shkolla "Rifat Manjani" në një tjetër shkollë në qendër të Shupenzës.

Shkolla "Rifat Manjani" është shkolla e parë në këtë zonë e cila ka 126 vjetorin e hapjes së saj. Sipas banorëve mbyllja e kësaj shkolle të parë shqipe është një padrejtësi e madhe që po i bëhet këtij fshati. Latif Dema, ish - mësues i kësaj shkolle u shpreh për Tv Bulqiza se "Ne nuk jemi dakort për mbylljen e kësaj shkolle. Kërkojmë rikthimin e fëmijëve në këtë shkollë". Banorët dhe mësuesit protestues thanë se nuk do ti dërgojnë fëmijët në asnjë shkollë tjetër dhe se mbyllja e kësaj shkolle është bërë për interesa të Zyrës Arsimore në



Bulqizë. Ata shprehën gjithashtu se kanë qenë të kënaqur nga mësimdhënja në këtë shkollë pasi nga këto banka shkolle kanë dalë kuadro të fushave të ndyshme.

Bashkia Bulqizë zgjidh problemin e ujit në Kovashicë

Vetëm dy ditë pas protestës që zhvilluan banorët e fshatit Kovashicë në Njësinë Administrative Shupenzë në Bashkinë e Bulqizës, kjo e fundit ka ndërhyrë për të zgjidhur problemin. Specialistët e ndër-



marrjes së Ujësjellës sh.a Bulqizë kanë bërë të mundur riparimin e defektit në rrjetin e ujetit, duke bërë rikthimin e ujit të pijshëm për banorët. Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Lefter Alla tha se bashkia ka reaguar menjëherë për shqetësimin e banorëve dhe se tashmë problemi ka marrë zgjidhjen e nevojshme. Nga ana tjetër, Alla tha se brenda dhjetë ditëve do të vëhet në funksion linja e ujësjellësit të ri pasi tashmë investimi është marrë në dorëzim nga Bashkia Bulqizë. Disa ditë më parë dhjetra banorë të fshatit Kovashicë në Shupenzë protestuan për mungesën e ujit të pijshëm. Edhe pse kishin në fshat dy rrjete furnizimi, ata nuk kishin ujë në çezmat e tyre. Dhjetra banorë të fshatit

Kovashicë në Njësinë Administrative Shupenzë në Bashkinë e Bulqizës protestuan ndaj mungesës së ujit të pijshëm. Banorët thonë se prej 10 ditësh i gjithë fshati është pa ujë të pijshëm edhe pse ka dy rrjete furnizimi. Sipas tyre, linja e ujetit është tejet e amortizuar, ndërsa linja e re nuk iu shërben aspak, duke i lënë në mëshirë të fatit. Banorët e Kovashicës fajësojnë ndërmarrjen e Ujësjellësit Bulqizë e cila sipas tyre nuk ka reaguar për zgjidhjen e problemit. Banorët kërkojnë që Bashkia Bulqizë të ndërhyjë për rivënie në funksion të pompës së ujësjellësit si dhe të vendosin në efikasitet linjën e re, pasi vërtetë në këtë mënyrë zgjidhet problemi i ujit të pijshëm.

Më 26 Tetor, ora 11.00 promovimi i librit të pestë të Ramazan Kicës në Muzeun Historik Kombëtar

promovimi

Romani "Lulja" me episode nga Bulqiza, si skaner i diktaturës

• **Nëpërmjet një procesi të gjatë e të ndërlikuar krijues, autori Kica dëshmon aftësinë për të treguar, për veten dhe për botën, për jetën dhe bëmat makabare të atij sistemi që degradoi deri në kalbëzim, duke përdhosur shoqërinë dhe familjen. Është koha kur siç thotë autori "sëmundja e gërbulës së lajkatimit i ka kapur pothuajse të gjithë". Përkundrejt atyre që "e njohin dashurinë në pafundësinë e saj, e dinë fort mirë që kënaqësia hyjnore që të fal ajo, vjen vetëm pasi ke përvetësuar virtytet e saj", janë përfaqësuesit më të urreyer të nomenklaturës së kuqe, të cilët autori i paraqet në formë episodike**

HALIL RAMA

Pas suksesit me botimet dhe studimet e para ("Shënime studenti në diktaturë", "Frida", Gavril Dara (i riu), në poemën "Kënka e sprasme e Balës", "Betejat e Skënderbeut me Ballaban Baderën", "Beteja e parë e Skënderbeut", "Lugina e Bu-s, Bulç, Bulqizë", "Dinastia Gropa", etj), studjuesi dhe shkrimtari Ramazan Kica vjen më së fundi para publikut me romanin "Lulja". Një roman, që siç shprehet autori që në hyrje "iu përket vetëm atyre që ndjejnë dhimbjen dhe ia kanë arritur, të paktën një herë në jetë, të prekin dashurinë plotësisht, në të gjithë madhësinë e saj". E prekën këtë llojë dashurie edhe dy heronjtë e kësaj veprë mjaftë të arrirë letrare, e përjetuan, siç ata deshën, por me fundin e përlotshëm, të parashkruar nga monstra të atij sistemi makabër.


Ndërsa si prolog i ngjarjeve të romanit është "Lulja – gjimnazistja që i ka ngjitur Arbenit përtej qiejve të jetës së amshuar, duke ndarë me të lumturinë e saj të dëlirë", epilogu është "padjallëzia e 18-vjeçares nga një fshat i rrethit të Bulqizës, në grahamat e fundit, shtrirë në shtratin e ndarjes së shpirtit nga materja..."

Kësisoj gjejmë në këtë roman portretizime e përshkrime brilante të ngjarjeve e rrethanave, të përjetimeve të dashurisë së dëlirë, por dhe të prapaskenave mizore për t'a çuar Lulen e padjallëzuar në shpirtin e saj, në fronin e përjetësisë.

Të skeduar e përshkruara si rrëfime ngjarjesh e episodesh prej më shumë se tri dekadash, autori Kica, pasi e kishte projektuar fillimisht si një novelë, taman si një arkitekt i vërtetë ligjërimesh të këndshme, ndërthur dy linjat që të çojnë tek një roman shumë i arrirë dhe mjaft tërheqës për lexuesin. Nëpërmjet një procesi të gjatë e të ndërlikuar krijues, autori Kica dëshmon aftësinë për të treguar, për veten dhe për botën, për jetën dhe bëmat makabare të atij sistemi që degradoi deri në kalbëzim, duke përdhosur shoqërinë dhe familjen. Është koha kur siç thotë autori "sëmundja e gërbulës së lajkatimit i ka kapur pothuajse të gjithë". Përkundrejt atyre që "e njohin dashurinë në pafundësinë e saj, e dinë fort mirë që kënaqësia hyjnore që të fal ajo, vjen vetëm pasi ke përvetësuar virtytet e saj", janë përfaqësuesit më të urreyer të nomenklaturës së kuqe, të cilët autori i paraqet në formë episodike.

Duke folur për Arabdurin, përfaqësuesin tipik të "kastës së fëlliqur shtazarake të pushtetit", e cila "është një tribu e llahtarshme, që jeton në të gjitha zyrrat e pushtetit, me kokën atje, në bulevard të kryeqytetit", në bashkëbisedim me të dashurën e tij, Lulen, Arbeni – një nga specialistët e zonës ku zhvillohen ngjarjet, që e njeh mirë jetën dhe fenomenet negative të saj, pohon se "Arabdurat janë kudo". Dhe se: "Këta tipa kanë pushtuar të gjitha kyçet e jetës së vendit. Dhe e keqja më e madhe nuk është kjo. Ajo e tmerrshmeja është se i gjithë populli po përvetëson huqet e tyre. Çdo njeri mendon vetëm si të arrijë e të kapë diçka, qoftë dhe duke humbur nderin... Pothuajse të gjithë ata që kanë një post, apo diçka në dorë sot, e kanë humbur nderin; i kanë dikurtizane, si gratë, vajzat dhe nënat e tyre, për të mos thënë që janë vetë të tilla..."

Në fakt, si Arbaduri, ky (pseudo) mjek që nuk dihet se "çfarë helmi ia kishte shkrirë format njerëzore", në zonën ku zhvillohen ngjarjet janë



edhe Lveri (brigadieri), edhe Trungu (sekretari i Partisë) e plot trungje të tjerë, drejtues të asaj kohe që s'bëjnë asgjë tjetër, veçse thurin intriga e skenarë ogurrezë në kurriz të intelektualëve me vlera e reputacion.

Në këtë mënyrë, romancieri Kica sjell tablo të gjera të realitetit shqiptar të para '90-ës. Dhe për ta bërë sa më të beseushëm e diskred atë sistem montsruoz, personazhet dhe veprimet e tyre i paraqet artistikisht në dy linja kryesore: linjën skematike të personazheve negativë, të përfaqësuar nga ish kuadro imoralë e pa katarkter, të mpleksur me linjën e dashurisë së dy të rinjve idealë, Arbenit e Lules, të marra veças, po edhe të gershetuara me njëra tjetrën.

Dhe nëse në linjën e parë takojmë deri edhe gratë e vajzat e njëri tjetrit, që pa pikë ngurimi i dërgonin vetë për t'u "zhagamajt me të madhin e partisë", në linjën e dytë janë "ata që e njohin dashurinë në pafundësinë e saj".

DASHURISË I DUHET DHËNË MË SHUMË VLERË SE JETËS

Gjuhën e pasur, herë-herë edhe dialektore (të dialektit të Bulqizës që është i veçantë, jo vetëm në Dibër por në gjithë Shqipërinë), mjetet shprehëse mjaft të gjetura, i hasim sidomos në përshkrimin e takimeve të Arbenit me Lulen tek "stacioni" i tyre apo poshtë manit (në mesnatë), në kopshtin e shtëpisë së Lules, kur "parfumi i frymëmarrjes së saj kishte pushtuar ambientin...". Dhe pikërisht në skena të tilla ai zbulon "virtytin e bukur, tek ata që dashurohen, i cili ka suksesin e një diamanti të madh...". Janë këto përjetime magjepsëse që e çojnë autorin në konkluzionin se "duke u ngjitur në majat më të larta të dashurisë, zemra njerëzore ka gjetur fronin për tu çlodhur, si dhe lëndinën e duhur ku të prehet shpirti. Në këta raste, ndjenjat e urrejtjes kalo-

jnë nëpër një tatëpjete të tillë të thepisur, sa zor se mund të gjejnë shesh për tu ndalur...". Parë nga ky këndvështrim R. Kica përçon mesazhin se: "dashurisë i duhet dhënë më shumë vlerë se jetës". Dhe se: "te njeriu që prehet në krahët e një bukurie hirplote, lind një shpirt tjetër". Kësisoj, aq i magjepsur është Arbeni nga bukuria fizike dhe shpirtërore e Lules, sa që i dhimbset kur e pushton dhe e mban në krahë. Është ky, Arbeni, që në fytyrën dhe në gjestet e tij ka një pamje fisnike ku mbisundon virtyti; tipari më i shenjtë e më hyjnor.

Në një tjetër këndvështrim ai na e paraqet heroin e veprës së tij, në dukje të gëzuar, por nga brenda të tejngopur duke pirë në këtë pellg vreri të efekteve të tiranisë...

Me një frazeologji interesante, në ekzaminimin perfekt që iu bën vemjeve të diktaturës, autori profilizon "kordin (Lverin-brigadierin) që kërkonte pëllumbeshën e bardhë në folenë e tij. Dhe këtë "kord" e stigmatizon mjaft bukur kur shkruan se "etja seksuale kishte ngjallur pasionet më të këqija të këtij përfaqësuesi tipik të racës epshore, duke nxjerrë në shesh gjithçka të fëlliqur që ka brenda gjallesa njerëzore, ndoshta, ndër gjërat e pakta që e ul njeriun një shkallë më poshtë se kafsha..."

Ndërkohë që kur zbulon planin e tij (brigadierit) për të shpëtuar nga ndëshkimi, pasi ka vjedhur në mesnatë kaun në stallën e ish kooperativës, për t'ia çuar mishin e tij "dhoratë" sekretarit të partisë që banonte në qytet, autori filozofon mjaftë bukur në ligërimin e tij se: "Vjedhja ka vrasjen me vete gjithmonë dhe ai nuk është i vetëm. Ata janë një grup i qepur mirë me njëri-tjetrin. S'ke ç'i bën kësaj kaste. Të gjithë janë pa karakter dhe të ulët. Është më keq kur përplasesh me një njeri të dobët, por dinak e tinëzar, sesa me një njeri të fortë, por të çiltër e të ndershëm. Të ligut, sa më pak t'i takojë ligjërisht diçka, aq më shumë ka dëshirë dhe kërkon ta ketë atë".

Mjafton qoftë dhe ky përcaktim filozofik i konceptit të vjedhjes për të konkluduar në koherencën që autori i jep veprës së tij letrare, po të kemi parasysh korrupsionin galopant në institucionet e shtetit të sotëm, që ushtrohet pothuajse me po ato metoda të vjedhjes së pasurisë shtetërore në sistemin e djeshëm, veçse sot në përmasa marmarandëse. Dhe për ta bërë sa më të besueshëm profilin e këtyre përbindëshave autori shkruan se: "Shëmtimi dhe shpërfytyrimi fizik kishte depërtuar në brendi, aq sa gjenetistët besojnë se ky denatyrim mund të ketë penetruar në gene. Kjo do të jetë hata që për shekuj e shekuj vështirë se do të riparohet. Specia normale humanoide i quajtur, thjeshtë njeri, kur bie në kontakt me ta, pyet veten se në ç'tribu me ecje pingule bëjnë pjesë këto gjallesa dykëmbësores të çuditshme, këto batate llumrash. Dhe gjithmonë përgjigja nuk vjen, ajo mbetet diku duke u vetëretur drejt shuarjes nëpër misteret e honeve të paqartësisë, megjithë protestën tënde të brendshme..."

"LULJA", NJË ROMAN QË ZË VEND TË VEÇANTË NË FONDIN E ARTË TË LETËRSISË SHQIPE

Nisur nga bagazhi jetësor, por veçanërisht në ligjërimin filozofik, qoftë për dashurinë dhe për

(Vijon në faqen 11)

libri

Akademia e Shkencave e Shqipërisë po tregohet e plogësht në këtë drejtim, ndërkohë që Akademia Bullgare vitet e fundit po futet

Origjina e gollobordasve të Dibrës (Kalabardhët)

NGA AGIM R. KASA

Gjithmonë kam qenë i mendimit që racat dhe etnitë e ndryshme të njerëzimit janë si një buqetë me lule të shumëllojshme e shumëngjyrëshe dhe bukuria qëndron në larinë e ngjyrave. Për mua do të ishte një lloj si të isha shqiptar, bullgar, maqedonas, serb apo grek. Por, e quaj ofenduese kur dikush përpiqet të të ndryshojë etninë. Besoj se kjo vlen për këdo. Ky është filli që përshkon përmbajtjen e këtij libri deri në fund. Njohësit shumë të mirë të zonës së Dibrës, prof. Kristo Frashëri dhe Hilmi Sadikaj nuk jetojnë më dhe gjërat në këtë zonë kanë evoluuar në sensin negativ. Akademia e Shkencave e Shqipërisë po tregohet e plogësht në këtë drejtim, ndërkohë që Akademia Bullgare vitet e fundit po futet edhe me studime etnokulturore për Gollobordën (Kalabardhën - emri i vjetër i saj), duke unifikuar "minoritetin" bullgar në Prespë, Gollobordë (Kalabardha) dhe zonën e Shishtavesit në Kukës, të cilat megjithatë nuk kanë të njëjtat rrjedha historike. Është krijuar kështu një vijë lindore "minoritare" në një kohë që gjysma e popullsisë shqiptare ndodhet jashtë kufirit shtetëror të Shqipërisë. Shteti shqiptar ka njohur "minoritetin" bullgar në Shqipëri pa e përcaktuar cilët janë dhe ku janë ata. Më parë ishte njohur vetëm minoriteti maqedonas në zonën e Prespës, por e njëjta zonë nuk mund të jetë edhe maqedonase edhe bullgare (vetëm në rast se e pranojnë maqedonasit që janë bullgarë)! Pavarësisht se nuk jam historian nga profesioni (që nga viti 1972 u përkas shkencave teknike), por meqenëse kjo është krahina e prindërve të mi, e kam ndjekur në vazhdimësi duke hulumtuar historinë e saj. Për këto arsye, dhe me qëllimin për të nxjerrë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, shkrova këtë libër të karakterit historik për dibranët e jugut ose gollobordasit (kalabardhët). Në këtë libër nuk do të trajtoj etninë e banorëve të Prespës, apo të atyre të Shishtavesit të Kukësit, që identifikohen sot si goranë, mbasi nuk kam njohuritë e duhura dhe ata nuk kanë të njëjtën rrjedhje ngjarjesh si fshatrat e Gollobordës (Kalabardhës), të cilat sikurse do ta shpjegoj në vijim, janë të njëjtë me Dibrën

e Epërme, ndërsa me Kukësin dhe Prespën i ndajnë me dhjetëra kilometra.

PUNA ME LIBRIN

Po e shkruaj këtë libër si një detyrim timin ndaj prindërve të mi, të cilët e ndjenin veten thellësisht shqiptarë dhe dibranë, madje të gjithë fëmijëve u vunë emra me kuptim në gjuhën shqipe. Po kështu, ata nuk na e mësuuan zhargonin e krahinës, të cilin unë nuk e di. Prindërit e mi nuk e përdorën asnjëherë, sikur ta parashikonin që zhargonin do të instrumentalizohet politikisht për të na ndërruar etninë (të dhënat sllave në këtë libër janë përkthyer nga gjuha angleze). Sikurse do të dalë në vijim, krahina e Gollobordës (Kalabardhës) do të ketë pikun e vet ekonomik në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Goditja që i dhanë serbët krahinës në vitin 1913 do të sillte pakësimin e popullsisë, e cila do të shpërngulej në qytete kryesore si Tirana, Elbasani, Durrësi dhe Shkodra. Familja ime i përket një lëvizjeje të mëvonshme, fill pas Luftës së Dytë Botërore. Besoj se jam nga qytetarët më të vjetër të qytetit të Peshkopisë që ende jetojnë, i lindur në lagjen e vjetër të saj, afër përroit. Prindërit e mi i përjetuan pretendimet maqedonase për krahinën dhe mirëpritën librin e Hilmi Sadikajt me titull "Gollobordasit e Dibrës" botuar në vitin 1999, një kopje të të cilit ma dhuruan edhe mua. Por, ata nuk përjetuan pretendimet bullgare, mbasi sikurse dihet, ato filluan më vonë, atëherë kur Bullgaria hyri në Bashkimin Europian dhe u bë me interes marrja e pasaportave bullgare. Që të justifikonin dhënien e këtyre pasaportave, bullgarët e ngritën çështjen edhe në Parlamentin Europian, me pretendimin se Shqipëria nuk njih minoritetin bullgar! Pra nga një çështje historike, ajo u kthye në një çështje politike. Unë jam takuar me historianin e nderuar Kristo Frashëri disa muaj përpara se ai të botonte librin e tij "Historia e Dibrës". Gjatë bisedës, i shpreha shqetësimin tim për pretendimet bullgare në drejtim të Gollobordës (Kalabardhës) dhe përpjekjet e tyre për të na ndryshuar etninë. Nga ai mësova se në Arkivin e Shtetit ndodhet një dokument shumë i rëndësishëm, një letër që populli



i Gollobordës (Kalabardhës) i kishte drejtuar Komisionit të gjashtë fuqive të mëdha, i cili kishte ardhur për të përcaktuar kufijtë e Shqipërisë me vendet fqinje. Në këtë letër thuhet qartë se kjo popullsi është shqiptare dhe kërkon që të jetë brenda kufijve të Shqipërisë. Për këtë periudhë do të shkruaj më gjerë në vazhdim, por në këtë rast dua të theksoj se brezi i gollobordasve (kalabardhësve) që jetoj në atë kohë, ndonëse në kushte më të vështira ekonomike dhe politike se sot, është treguar më patriot, dhe është ky brez, ai që i vuri vulën shqiptarizmit. Ndërmjet historianëve vendas, dua të veçoj Hilmi Sadikajn, i cili me librin e tij "Gollobordasit e Dibrës", na dha shumë dokumente të vlefshme si dhe shumë intervista me të moshuar që kishin lindur në shekullin e XIX. Mendimi i këtyre pleqve është shumë i vlefshëm, sepse ata janë gjyshërit apo stërgjyshërit tanë, madje edhe të ndonjërit, që për qëllime që i dinë vetëm ata, na paraqesin ne si bullgarë apo maqedonas. Po kështu është i vlefshëm edhe përcaktimi i tij se jemi 99 për qind shqiptarë, duke lënë një shteg prej 1 për qind që mund të vijë nga martesat e ndërthurura me sllavët ose ndonjë familje sllave e vendosur aty.

BAZUAR NË DOKUMENTE DHE FAKTE

Ashtu si në shkencën e astronomisë ku nuk mund të bëhet asnjë hap përpara pa u bazuar në zbulimet e mëparshme të autorëve të tjerë, edhe në atë të historisë shkohet nga e njohura tek e panjohura. Si çdo libër tjetër historik, edhe ky nuk është krijimtari, por bazohet në dokumentet dhe faktet që kanë paraqitur autorët të tjerë, veçanërisht Kristo Frashëri dhe Hilmi Sadikaj. Qëllimi i botimit të këtij libri është për të lidhur "hallkat" që kanë krijuar të tjerët në një "zinxhir" ku të duket qartë etniciteti shqiptar i gollobordasve (kalabardhasve), si kundërvënie ndaj spekulimeve të reja të pabazuara në dokumente, veçanërisht të atyre bullgare. Lexuesi do të jetë ai që do të vlerësojë se sa ia kam arritur qëllimit. Duke u ruajtur që të mos shtrembëroj asgjë, si "busull" orientimi po marr shënimin e Moikom Zeqos, në gazetën "Dita" të datës 24.11.2018 ku shkruan se: "Historia është një proces ngjarjesh, dukurish dhe figurash njerëzore, të cilat janë të bazuara në një rezultante historike të përcaktuara shumë qartë... Historianët seriozë mbrojnë karakterin objektiv të historisë dhe janë kundër të gjitha pikëpamjeve antishkencore që e mohojnë historinë në thelb, ose e metamorfozojnë, sipas interesave dhe opinionëve politike. Historia nuk është asnjëherë apriori. Por historia nuk është asnjëherë diçka aposteriori. Historia është ajo që ka ndodhur. Historia nuk konceptohet me një prapavijë dëshirore, pra sipas një "në qoftë se", pra si do të kishte ndodhur kjo histori në se do të ishte zhvilluar ndryshe, apo pse kjo histori që ka ndodhur në këtë mënyrë nuk duhet të kishte ndodhur, sepse një etapë që vjen pas saj, mund të jetë në kundërshtim, ose ndryshe nga etapa paraardhëse."

("Origjina e gollobordasve të Dibrës (Kalabardhët)" botimi më i ri nga "Dituria")

Romani "Lulja" me episode nga Bulqiza, si skaner i diktaturës

(Vijon nga faqja 10)

urrjetjen ndaj të damkosurve si sahanlëpirës të diktaturës, shprehim bindjen se autori Kica, sjell për lexuesin një roman që hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe. Ligjërime të tilla si: "Burrat fitojnë beteja, femrat jo, ato fitojnë zemra dhe gjejnë miq", apo "Miqte që tregojnë dashamirësi të tepruar janë më të këqij se armiqte e tërbuar", dëshmojnë për një autor që ka lexuar e përvetësuar shkrimtarë e filozofë të shquara botërorë, si Dante Aligeri, U. Shekspir, Xhon Gollsuorthi, apo dhe piktorin francez Jean-François Raffaëll, të cilët edhe i perifrason me vend në përshkrimin e ngjarjeve e detajeve kulmore.

Kjo e ka ndihmuar autorin që të na sjell përsosmërisht diktaturën komuniste në skanerin artistik. Mjafton për këtë qoftë edhe përcaktimi gjeneral që autori Kica i bën "njeriut të ri" të sistemit komunist, siç quhej në ata vite, si monstër unikal. "Një lloj çude e përçudnuar në përdhosje të shpërfytyruar. Kënaqësi i jepte vetëm ligësia...", kur "shpirti i ishte holluar e mprehur tej logjikës së intrigës më të ulët njerëzore, objekti i vetëm që do ta kishte zili edhe tinëzia bizantine e tjerrur në netët e Orientit gjatë mijëra vitesh".

Duke bërë një skanim ekzakt të atij sistemi monstruozi autori Kica na jep shëmtimin dhe shpërfytyrimin fizik të njeriut të ri të partisë në ato vite që "në realitet nuk ke si t'i quash ndryshe

këto krijesa të çuditshme vertikale, sepse në sjelljet e tyre shfaqeshin, turbull, tiparet e njerëzve".

Nisur nga fundi përletës i Lules, autori përcejll mesazhin se "parandjenja e fatkeqësisë e pikllon shpirtin duke vrarë më rëndë se vetë fatkeqësia..."

Të gjithë shikonin drejt qiellit, ku: "Në një rrëpirë të tillë të frikshme ku dhe ëndërra do të zbrapset, ... si në një kretaurë të patrajtëshme, dy instinkte pa formë dhe caqe, po kacafyteshin për jetë e vdekje me njëri tjetrin. Njëri ishte i zi, ndërsa tjetri i bardhë. Ndoshta, për t'i ndriçuar të ardhmen e mallkuar Bulqizës, i ziu e munda të bardhin duke e shtyrë në një hon trishtues dhe gëlltitës, nga një rreckadë si urë greminë...". Nga ky këndvështrim i autorit të suksesshëm R. Kica, "jeta është asgjë më shumë se humbja e pandërprerë e njerëzve që duam!"

Dhe libri përfundon me një "çlirim habitës", të një grupi të madh njerëzish, të cilët, nga ana lindore e luginës së Bulqizës shikonin që "atje tej drejt perëndimit, në fund të horizontit, Bulqiza filloi të zhytej në përjetësinë e zezë të territ duke u munduar të zhdukë hijen e saj si për të fshehur diçka! Diç, si puhizë e purpurtë në agullim, po rrinte varur si e panjohura. Ishte pafajësia, e cila, duke qenë në vetvete misteri më i shenjtë njerëzor, qëndron më lart dhe se virtyti. Më shumë ndjehej sesa shihej. Si një fole që qëndron pezull mbi greminë, përballë madhështisë së saj, venitet gjithçka që është e madhërishtme në këtë botë".

Kur fuqishëm dridhet zemra,
Afrohu të lutem njëherë ngadalë;
Lexo syrin çfarë sheh brenda,
Det me fjalë, i njejt mall....

letrat

Arti i fjalës

-Poezi nga Barie Çupi

AMANETI

Një amanet dua të shkruaj,
Për sot, për nesër e kaherë;
Si leter kujtесе këtu t'a ruaj...
Ti thjesht, lexoje nganjëherë.

Nuk e di...,kur dora të fillojë të ndalet,
Do jemi pranë apo shumë larg?!
Ca grimca ndjenjash do përmallen;
Nuk n'a bashkoi i njejt fat!

Diku respekti do jetë i pari,
Mirënjohja si urtësi...
Ëndrrat do n'a i shlyejë veç varri,
Ndoshta jetojmë në përjetësi.

I ngatërruar nëpër vargje,
Veç emri yt gjallë më mbeti,
Më duaj pakëz për sy e faqe.
Ndoshta ky është amaneti....

SEKRETI I VJESHTËS

Ja dhe një varg për ty e vodha,
Me shikimin fshehur pas hijes tënde;
Edhe e humbur s'të harrova
Kur ti harrove të më përmendje.

Ja dhe një varg shtrënguar në gjoks
Me mall, me afsh sikur dje;
Të zgjosh një botë s'është paradoks,
Unë prapë të dua, ti je atje.

Ja dhe një varg, jo si gjithmonë!
Kur vjeshta vesh fustanin e verdhë
E ruajta relike në librin tonë
Por të fundit varg në shpirt e kam
derdhë.

ARTI I FJALËS

Kur butësisht ulet fjala,
Në fund të shpirtit, në çdo kënd;

Në qiell mbledh yje të arta...
Dhe zbukuroj portetin tënd.

Kur pafajësisht heshtja mund,
Kërkoj vargje vetëm për ty;
Art' i fshehur, ngjyra pafund;
Në çdo mendim të gjej aty..

Kur fuqishëm dridhet zemra,
Afrohu të lutem njëherë ngadalë;
Lexo syrin çfarë sheh brenda,
Det me fjalë, i njejt mall....

Kur të zgjohesh i vërtetë,
Puthe ëmbël vargun tim;
Lermë të hidhem prap në det,
Të zhytem thellë me gjithë trishtim...

NËSE...

Nëse më sheh me shpirt të vrarë,
Nëse më sheh duke ecur e qarë,
Nëse më sheh të ligur;
Të tretur.

Të prishur,
Të rënë....
Çelësin e varrit kam gjetur,
Një vend për të zënë....

Nëse më sheh të thyer,
Të heshtur,
Me zemër gërryer
e lëkurën prej mallit veshur...
Ti mos u ligështo!

...përshëndetmë,
...përqaqomë dhe nga larg,
por mos më pengo.
Nëse më sheh ditën;
Mos m'a kujto natën!
Mos më thuaj asgjë,
Se më lëndon plagën...
Nëse papritur filloj e buzëqesh;
Arsyeja për një çast,
Vetem ti do të jesh..

RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë
dhe çmime të përbalueshme

Një program i rezervuar
dhe personalizuar për
qytetarët shqiptarë për
të hyrë në shërbime
shëndetësore me cilësi të
lartë dhe çmime të përbalueshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatorial përbërë nga 11 qendra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundësohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË:

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përbalueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,
- resonance magnetike, tac - Mamografi dhe tomosintezë, -

ekografi ... me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit).

ORGANIZOJMË GJITHÇKA në kohën që ju ose i afërmi juaj do asistohen/ni në strukturat tona.

- Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na \kontaktoni: Email: age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580
WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose i afërmi juaj do asistohen/ni në strukturat tona.

- Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)
0695300053 (Shqipëri)



BARIE BOBA ÇUPI

Lindi më 06 prill 1972 në Dragut të Bulqizës. Mbaroi studimet në fakultetin e gjuhëve të huaja, dega "Frëngjisht", Tiranë.

Ka botuar herë pas here poezi në shtypin letrar si: gazeta "Rruga e Arbërit", antologjia "Na bashkoi poezia".

Aktualisht punon mësuese e gjuhës frënge në shkollën 9-vjeçare "Shefqet Tançi" në qytetin e Bulqizës.

"Vargonjtë e fatit" është libri i saj i parë.

Mbyllur përjetësisht,
në retinën e syve të dridhës,
zhytur silueta jotë si vegim,
në mendimet që ujiten,
nga vesa e mëngjesit,
shpërtihen malli e përmbyt gjoksin tim.



Çmimi: 500 lekë

